



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

RAPORTI VJETOR

2023

Prishtinë, 2024

RAPORTI VJETOR 2023

Përmbajtja

FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE.....	7
RAPORTI VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2023	15
SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE	17
NJËSIA LIGJORE.....	21
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE	25
DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT	35
DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE	47
DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE	51
NJËSIA E PROKURIMIT	59
NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIAVE	63
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	69
ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM	73
AKTIVITETET TJERA TË GJYKATËS KUSHTETUESE.....	77
SHTOJCA I.....	91
ORGANOGRAMI	95

FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE

Viti 2023 shënon një rrugëtim jo medoemos të lehtë, por megjithatë të suksesshëm për Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese rritet e zhvillohet bashkë me vet Republikën e Kosovës. Prandaj, momentet që kanë shënuar vitin që lamë pas, janë pashmangshëm të ndërlidhura me fazat e trendet e zhvillimit të një shteti e demokracie të re, siç është Republika e Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në përmbushjen e misionit të saj si gardian i Kushtetutës, gjatë vitit 2023 ka thelluar më tej konsolidimin e saj institucional, si dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, bazuar në vlerat dhe parimet demokratike e të sundimit të ligjit, siç burojnë nga normat kushtetuese, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Në këtë Raport Vjetor, lexuesit mund të gjejnë një përmbledhje të aktivitetit gjyqësor të Gjykatës përgjatë vitit 2023, si dhe informata me rëndësi lidhur me punën e Gjykatës dhe secilit departament të saj. Të dhënat statistikore të paraqitura këtu ofrojnë një pasqyrë të qartë lidhur me kërkesat e pranuar dhe të zgjidhura, tipologjinë e shkeljeve kushtetuese të pretenduara para Gjykatës, aktivitetet administrative, vizitat zyrtare dhe punëtoritë e mbajtura, si dhe informata të detajuara përkritazi me menaxhimin e financave publike.

Viti 2023 ka shënuar trend të ngjashëm me vitin paraprak për sa i përket kërkesave të reja të regjistruara. Janë regjistruar gjithsej 294 kërkesa të reja, ndërsa 112 janë bartur nga vitet paraprake. 276 prej kërkesave të regjistruara më 2023, janë parashtruar nga persona fizikë e juridikë, ndërsa 18 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet publike. Në vitin 2023 është shënuar numri më i lartë i kërkesave të parashtruara nga organet shtetërore brenda një viti të vetëm kalendarik, përfshirë në kontekst të numri të ligjeve të kontestuara. Përgjatë vitit 2023, janë zgjidhur dhe publikuar në ueb-faqen e Gjykatës 209 vendime, prej të cilave (i) 33 Aktgjykime, 17 prej të cilave ndërlidhen me kërkesa institucionale; (ii) 147 Aktvendime për Papranueshmëri si rezultat i vlerësimit të meritave të rasteve përkatëse dhe/ose kriterëve procedurale të pranueshmërisë; dhe (iii) 10 Vendime për Refuzim të kërkesave e 19 vendime dhe/ose urdhra të tjerë.

Kjo veprimtari gjyqësore, me numër të lartë të kërkesave të regjistruara dhe të zgjidhura, përtej sfidave, ka paraqitur gjithashtu mundësi për zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të drejtësisë kushtetuese në vend. Shquaj këtu sidomos kërkesat institucionale, përmes të cilave janë trajtuar çështje si: (i) ndarja dhe ndërveprimi i pushteteve dhe pavarësia e pushtetit gjyqësor dhe sistemit prokurorial; (ii) ndarja e kompetencave dhe ndërveprimi në mes të nivelit qendror dhe lokal; (iii) funksionimi i administratës publike; (iv) ekonomia e tregut të lirë; dhe (v) liria e medias, përfshirë pavarësinë dhe mbikëqyrjen e transmetuesit publik. Krahas tyre, përmes vendimeve që kanë trajtuar kërkesa individuale, është ndërtuar dhe konsoliduar praktika gjyqësore lidhur me çështje si: (i) parandalimi i dhunës në familje dhe zbatimi i Konventës së Stambollit; (ii) aspekte të ndryshme të të drejtës në gjykim të drejtë, përfshirë parimin e barazisë së armëve dhe paraqitjes së dëshmive në procedurë penale, gjykatës së themeluar me ligj, si dhe tejzgjatjes së procedurave gjyqësore; (iii) e drejta e lirisë dhe sigurisë, në kontekst të afateve ligjore për mbajtje në paraburgim; (iv) licenca si e drejtë pronësore; dhe (v) të drejtat aktive dhe/ose pasive zgjedhore.

Në vijim, do të përvijoj shkurtimisht dhe në mënyrë të përmbledhur vendimet e rëndësishme të Gjykatës nga këto kategori. Siç mund të vërehet edhe nga vendimet e plota, të cilat lexuesi mund t'i gjej në uebfaqen e Gjykatës në shqip, serbisht, anglisht dhe me raste edhe në frëngjisht, secilit prej këtyre vendimeve u ka paraprirë një analizë e thellë, me referencë në praktikën krahasimore dhe standardet ndërkombëtare relevante për fushën dhe/ose çështjen përkatëse.

Viti 2023 është karakterizuar nga iniciativa për reforma thelbësore në sistemin e drejtësisë. Gjykata Kushtetuese ka pasur rastin të trajtojë aspekte të caktuara lidhur me këto iniciativa brenda kompetencave të veta kushtetuese për kontroll preventiv dhe vlerësim paraprak të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese. Janë dy Aktgjykime me rëndësi që kanë konsoliduar edhe më tej parimet kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial. Të dy këto Aktgjykime që do të përshkruhen shkurtimisht më poshtë, në esencë, reflektojnë se funksionimi dhe administrimi i mirëfilltë i drejtësisë, përfshirë edhe besimin e publikut në këtë sistem, reflekton një ndër parimet më esenciale të një shoqërie demokratike të bazuar në sundimin e ligjit, parim ky i cili është vlerë themelore e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Në Aktgjykimin në rastet e bashkuara KO100/22 dhe KO101/22, në të cilin Gjykata ka vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjit përmes të cilit ndryshohej dhe plotësohej ligji në fuqi për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Gjykata ritheksoi se ndarja dhe ndërveprimi i pushteteve është një ndër vlerat themelore të mishëruara në Kushtetutë dhe mbi të cilën bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës. Gjykata më tutje theksoi se Kushtetuta ka përcaktuar mekanizmat e kontrollit dhe ndërveprimit në mes të tri pushteteve të pavarura që përbëjnë trekëndëshin klasik të ndarjes së pushteteve, por edhe në raport me institucionet e pavarura kushtetuese. Thelbi i ndarjes së pushteteve qëndron pikërisht në atë se si këto pushtete duhet të kontrollojnë dhe të balancojnë njëra-tjetrën, pa krijuar ndonjë ndërhyrje, varësi apo vartësi të pushteti tjetër. Në këtë frymë, ky Aktgjykim sqaroi, ndër tjerash, aspekte me rëndësi lidhur me (i) pavarësinë e sistemit prokurorial, përfshirë detyrimet përkatëse për llogaridhënie, bazuar në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe ekuilibrin e nevojshëm në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial; (ii) kompetencat kushtetuese të Avokatit të Popullit; (iii) çështjen e sigurisë së mandateve të prokurorëve dhe ndërlidhshmërinë e ngushtë të saj me pavarësinë e prokurorëve në veçanti dhe sistemit prokurorial në përgjithësi; dhe (iv) barazinë para ligjit në kontekst të mjetit juridik dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave.

Ndarja e pushteteve dhe pavarësia e sistemit gjyqësor kanë qenë kryefjalë edhe në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO55/23, lidhur me vlerësimin paraprak të amendamenteve kushtetuese për vetingun në sistemin e drejtësisë. Gjykata ka theksuar sërish rolin e Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial si institucione të pavarura kushtetuese në arkitekturën shtetërore të Republikës së Kosovës. Duke theksuar se pavarësia e sistemit gjyqësor është gurthemel i sundimit të ligjit, ky Aktgjykim sjell në pah sërish ndërlidhshmërinë e ngushtë në mes të mënyrës së zgjedhjes dhe shkarkimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me pavarësinë e tyre. Aktgjykimi më tutje shtjellon se, duke marrë parasysh ndërlidhshmërinë e ngushtë në mes të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe sistemit prokurorial me sigurinë e mandateve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kriteret për shkarkimin e tyre duhet të ofrojnë nivelin më të lartë të sigurisë dhe parashikueshmërisë juridike. Përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata i ka hapur rrugën zhvillimit të vetingut në sistemin e drejtësisë, si një reformë që, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykimin në fjalë, duhet megjithatë të përmbajë garancitë e nevojshme për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe vlerat themelore kushtetuese.

Në vitin raportues, Gjykata publikoi gjithashtu Aktgjykimet lidhur me dy iniciativa të rëndësishme ligjore në saje të reformës së administratës publike, kërkesa të cilat u referuan në Gjykatë nga Avokati i Popullit. Kërkesat e regjistruara si KO216/22 dhe KO220/22 (raste të bashkuara) dhe KO79/23, rikthyen për vlerësim të kushtetutshmërisë para Gjykatës Kushtetuese Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, respektivisht. Fakti që për të dy këto çështje Gjykata veçse kishte thënë një herë fjalën e saj më 2020 dhe po riktheheshin në vlerësimin e saj, ndër tjerash, reflektoi faktin që parimet e shtjelluara detajisht përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, jodetyrimisht ishin marrë parasysh në tërësinë e tyre, nga dy pushtetet tjera, në hartimin e ligjeve përkatëse të reja.

Përmes dy Aktgjykimeve të reja, Gjykata pjesërisht shfuqizoi dy ligjet e kontestuara para saj, përkatësisht Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Ligjin për Pagat në Sektorin Publik. Gjykata sërish vuri theks në parime thelbësore kushtetuese, përfshirë në kontekst të Ligjit për Zyrtarët Publikë çështje që, ndër tjerash, ndërlidhen me: (i) pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese në raport me kompetencën mbikëqyrëse të Qeverisë; (ii) parimin e sigurisë dhe parashikueshmërisë juridike, në kontekst të efektit juridik të një norme në të drejtat e fituara pas dhe para hyrjes së saj në fuqi; dhe (iii) të drejtën për mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore. Ndërsa sa i përket Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, sipas fushëveprimit të kërkesës së Avokatit të Popullit, Gjykata kufizoi shqyrtimin e vlerësimit të kushtetueshmërisë vetëm sa i përket kategorisë së funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve të cilëve ju ishte ulur niveli i pagës përmes ligjit në fjalë. U vlerësuan, ndër tjerash, dispozitat përkatëse për sa i përket (i) zbritjes së pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që njëherësh, proporcionalisht, ishin kategoria më e afektuar, me zbritje deri në pesëdhjetë (50%) përqind të vlerës së pagës paraprake; (ii) zbritjes së pagave të funksionarëve, zyrtarëve dhe nëpunësve tjerë; (iii) dallimit në trajtim të shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës; (iv) dallimit në trajtim në kontekst të nivelit të pagës për të punësuarit pas hyrjes në fuqi të ligjit në fjalë; dhe (v) ndryshimi i formulës së llogaritjes së shtesës për përvojë të punës që kishte ndikuar në zbritjen e vlerës së kësaj shtese për të gjithë kategorinë e zyrtarëve publik për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojes së punës.

Ndër premisat bazë të vlerësimit të kushtetueshmërisë së dispozitave të kontestuara të të dy këtyre ligjeve, ishte qëndrimi veçse i konsoliduar përmes praktikës së Gjykatës, se (i) Kuvendi ka kompetencën e plotë kushtetuese për miratimin e ligjeve dhe përzgjedhjen e politikave që ndërthejnë të njëjtat, për aq sa ligjet e miratuara të jenë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e proklamuar aty; dhe (ii) sipas praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore, në vlerësimin e kushtetueshmërisë së akteve të kontestuara, Gjykata fokusohet vetëm në interpretimin dhe mbrojtjen e normave kushtetuese dhe jo në vlerësimin e përzgjedhjes së politikës publike që ka dërguar deri tek miratimi i një ligji të caktuar. Sikurse Aktgjykimi në lidhje me Ligjin për Zyrtarët Publikë, edhe shqyrtimi i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, ju nënshtrua një analize të thellë, që mori për bazë praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, si dhe praktikën krahasuese të gjykatave tjera kushtetuese dhe gjithashtu, Opinionet dhe Raportet relevante të Komisionit të Venecias dhe Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë.

Përgjatë vitit 2023, përmes praktikës së saj gjyqësore, Gjykata gjithashtu sqaroi parimet thelbësore që ndërlidhen me ekonominë e tregut të lirë. Më saktësisht, Aktgjykimi në rastin KO173/22, lidhur me vlerësimin e kushtetueshmërisë së Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg, për herë të parë trajtoi konceptin e ekonomisë së tregut të lirë, në përputhje me nenet 7 [Vlerat], 10 [Ekonomia] dhe 119 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës. Duke theksuar fillimisht se ekonomia e tregut është vlerë e Republikës së Kosovës dhe se ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi sqaroi se në parim dhe në kontekst të emëruesit të përbashkët që buron nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe praktikës krahasimore të gjykatave tjera kushtetuese anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, masat e përkohshme mbrojtëse në kontekst të importit, eksportit, përfshirë në rrethana të destabilizimit të tregut, janë të mundshme, për aq sa të njëjtat janë të “përcaktuara me ligj”, ndjekin një “qëllim legjitim” dhe janë rreptësisht “proporcionale”. Megjithatë, Aktgjykimi sqaroi që bazuar në paragrafin 5 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, kompetencën për vendosjen e masave të këtylla kufizuese, e kanë organet e pavarura për rregullimin e tregut. Përmbledhur shkurtimisht, Gjykata vlerësoi se përderisa nenet e kontestuara të ligjit në fjalë, në parim, përcaktonin masa kufizuese përmes ligjit, që ndiqnin qëllim legjitim dhe ishin proporcionale, nuk përmbushej kushti i vendosjes së tyre nga organe të pavarura. Për më tepër që, Ligji i kontestuar nuk kishte amedamentuar dhe/ose shfuqizuar dispozitat përkatëse ligje tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës,

përkatësisht (i) Ligji nr. 03/L-244 për Rezervat Shtetërore të Mallrave; dhe (ii) Ligji nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme ndërlidhur me Ligjin nr. 04/L-005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, që përcaktojnë mekanizma të ngjashëm për masat e përkohshme për produktet themelore në raste të veçanta, duke rezultuar kështu në disa lidhe të aplikueshme në të njëjtën fushë me rregullime e përcaktime të ndryshme, dhe për pasojë, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, si vlerë thelbësore e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Përgjatë vitit 2023, Gjykata gjithashtu konsolidoi më tej parimet që ndërlidhen me vetqeverisjes lokale dhe ndërveprimin në mes pushtetit lokal dhe qendror. Aktgjykimet në rastet e bashkuara KO159/21 dhe KO160/21 dhe në rastin KO177/23, kanë zbërthyer e zbatuar në rrethanat e rasteve përkatëse parimet përkitazi me vetqeverisjen lokale të përcaktuara me Kushtetutë, Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias. Përmes këtyre Aktgjykimeve, Gjykata, ndër tjerash, shtjelloj më tej çështje që ndërlidhen me ushtrimin e kompetencave të plota dhe ekskluzive të komunave dhe kontrollin administrativ të autoriteteve qendrore mbi ato lokale, duke ritheksuar, ndër tjerash, që (i) njësi themelore territoriale të vetqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat dhe kompetencat e tyre rregullohen me ligj; (ii) komunat kanë kompetenca “vetanake”, “të zgjeruara” dhe “të deleguara”; dhe (iii) rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën dhe me ligjin.

Tutje, vlen të theksohet edhe Aktgjykimi në rastin KO134/21, i cili i dha Gjykatës mundësinë që të shtjellojë për herë të parë disa aspekte specifike lidhur me vlerat kushtetuese të përcaktuara me nenin 7 [Vlerat], nenin 40 [Liria e Shprehjes] dhe nenin 42 [Liria e Medieve] të Kushtetutës. Në vlerësimin e aktit të Kuvendit, përmes të cilit ishin shkarkuar kolektivisht anëtarët e organit titullar të RTK-së, transmetuesit publik në Kosovë, shtesë praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata analizoi parimet dhe standardet që burojnë nga një varg aktesh të Komitetit të Ministrave e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Opinione të Komisionit të Venecias dhe raporte të Unionit Evropian të Transmetuesve. Aktgjykimi theksoi se garancitë për pavarësinë dhe autonominë e transmetuesit publik burojnë nga garancitë kushtetuese dhe të instrumenteve të aplikueshme ndërkombëtare përkitazi me lirinë e shprehjes dhe lirinë e medieve sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe vet Ligjit për RTK-në. Në këtë rast, Gjykata gjeti se Kuvendi kishte tejkaluar kufijtë e kompetencës mbikëqyrëse të përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe për më tepër, kishte cenuar pavarësinë e transmetuesit publikë, roli i të cilit është thelbësor për lirinë edhe pluralizmin e medieve në një shoqëri demokratike, në kundërshtim me vlerat e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në fund dhe në kontekst të interpretimit të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutë dhe instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare, Gjykata, përgjatë vitit raportues, përtej konsolidimit të praktikës gjyqësore, gjithashtu ka zgjeruar të njëjtën. Më poshtë, në mënyrë krejt të përmbledhur, do të përvijoj disa prej rasteve individuale që meritojnë vëmendje të posaçme për shkak të tipologjisë dhe rëndësisë në kuptim të sendërtimit të parimeve dhe standardeve të drejtësisë kushtetuese për sa i përket të drejtave dhe lirive themelore, me theks në (i) të drejtën për jetën dhe detyrimet pozitive të shtetit që burojnë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa e Stambollit; (ii) të drejtave aktive dhe pasive zgjedhore, me theks në lirinë dhe fshehtësinë e votës; (iii) të drejtën për liri dhe siguri, me theks në kriteret e aplikueshme përkitazi me përcaktimin dhe vazhdimin e masës së paraburgimit; dhe (iv) të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, me theks në qasjen në drejtësi, procedurat e tejjzgjatura gjyqësore dhe kriteret e nevojshme për vendosjen e masave të sigurisë dhe/ose masave të përkohshme.

Në kontekst të kategorisë së parë, vlen të theksohet Aktgjykimi në rastin KI129/21, përmes të cilit, Gjykata ka interpretuar obligimet e institucioneve shtetërore në kuptim të nenit 25 [E drejta për Jetën] të Kushtetutës, gjithashtu në dritën e obligimeve që ka marrë përsipër Republika e Kosovës përmes Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje, duke e zbatuar për herë të parë kështu në praktikën e saj këtë instrument ndërkombëtar, të njohur si Konventa e Stambollit. Përderisa Konventa e Stambollit paraqet një risi në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, vlerësimi i (mos)veprimeve të autoriteteve shtetërore për të mbrojtur jetën në kontekst të dhunës në familje, fatkeqësisht, nuk është terren krejtësisht i ri në jurisprudencën e Gjykatës, meqenëse Gjykata në fillat e saj kishte konstatuar shkelje të së drejtës në jetë në rastin KI41/12.

Në kontekst të kategorisë së dytë, rëndësi të veçantë ka Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI69/21, përmes të cilit janë theksuar parimet kushtetuese që ndërlidhen me votën e barabartë, të lirë dhe fshehtë në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Përmes këtij Aktgjykimi dhe duke u bazuar në parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komisionit të Venecias, emëruesit e përbashkët që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatave tjera Kushtetuese, janë sqaruar parime thelbësore që ndërlidhen me të drejtat pasive dhe aktive zgjedhore sipas përcaktimeve të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 3 (E drejta në zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përmes këtij Aktgjykimi Gjykata, ndër tjerash, ka theksuar që përkundër faktit që Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton vende të garantuara për komunitetet që nuk janë shumicë, e drejtat aktive e votës, nuk mund t'i nënshtrohet asnjë lloj kushtëzimi, sepse ajo bazuar në Kushtetutë, është e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

Në kontekst të kategorisë së tretë, Gjykata ka vendosur parime që ndërlidhen me të drejtën e lirisë dhe sigurisë në kontekst të kriterëve të nevojshme për përcaktimin dhe/ose vazhdimin e paraburgimit. Përmes Aktgjykimeve në rastet KI129/22, KI55/22 dhe KI85/22, Gjykata ka trajtuar nenin 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në kontekst të afateve ligjore për mbajtje në paraburgim para ngritjes së aktakuzave përkatëse. Gjetjet e Gjykatës në rrethanat e rasteve në fjalë, parimisht, theksojnë që çdo kufizim i të drejtës së lirisë dhe sigurisë, përmes masave të paraburgimit për të akuzuarit në procedurë penale nga ana e gjykatës kompetente, duhet të jetë në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm dhe të jenë arsyetuar në kontekst të pretendimeve thelbësore të palëve përkatëse.

Në fund, dhe në kontekst të kategorisë së katërt, Gjykata më tej ka konsoliduar parimet që ndërlidhen me të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si një nga të drejtat kushtetuese me rol thelbësor për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës. Përgjatë vitit 2023, janë trajtuar aspekte specifike të kësaj të drejte, përfshirë Aktgjykimet në rastet: (i) KI161/21, në kontekst të barazisë së armëve dhe paraqitjes së dëshmive në procedurë penale dhe rëndësisë së marrjes parasysh të dëshmive në kontekst të dhunës në familje; (ii) KI214/21, në kontekst të qasjes në drejtësi dhe nënshtimit të vlerësimit të ligjshmërisë së dekreteve presidenciale nga gjykatat e rregullta; (iii) KO64/23, në kontekst të gjykimit në kohë të arsyeshme, përkatësisht tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, duke ritheksuar standardet e aplikueshme në këtë kontekst; dhe (iv) KI21/23, KI36/22 dhe KI143/22, në kontekst të kriterëve ligjore dhe proporcionalitetit të nevojshëm në vendosjen e masave të sigurisë dhe/ose të përkohshme nga gjykatat e rregullta deri në zgjidhjen përfundimtare dhe/ose meritore të rasteve përkatëse.

Vendimet e plota të rasteve si më sipër dhe të gjitha vendimet tjera të Gjykatës, përfshirë përmbledhjet dhe njoftimet përkatëse për publikun, janë të publikuara në ueb-faqen e Gjykatës në dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në gjuhën angleze dhe në disa raste, edhe në frengjisht. Gjithashtu, të gjitha Aktgjykimet dhe Aktvendimet më të rëndësishme janë të përmbledhura dhe publikuara në Buletinet e Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese që publikohen në ueb-faqen e Gjykatës në baza mujore, tremujore dhe vjetore.

Krahas aktivitetit gjyqësor, Gjykata ka ndërmarrë dhe zbatuar një varg aktivitete të dizajnuara për të avancuar më tej cilësinë dhe efikasitetin e funksionimit të saj të brendshëm dhe përforcimin e mekanizmave për transparencë të shtuar dhe komunikim efektiv me publikun. Në përputhje me objektivat e qëllimet strategjike të saktësuara në Planin Strategjik (2021-2025) të Gjykatës, janë zbatuar plot 80% të aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Veprimit të Planit Strategjik (2021-2023), të cilat mund të ndahen në dy grupe çështjesh.

Grupi i parë përfshin përditësimin dhe avancimin e rregullativës së brendshme dhe sidomos hyrjen në fuqi të Rregullores së punës së Gjykatës nr. 01/2023 në korrik të vitit që lamë pas. Ndër ndryshimet më thelbësore që mund të shquhen në Rregulloren e re janë: (i) rritja e efikasitetit në vendimmarrje përmes, ndër tjerash, shkurtimit të afateve të brendshme procedurale që ndërlidhen me publikimin e një vendimi gjyqësor pas vendimmarrjes; (ii) rritja e transparencës, sidomos në vendimmarrjen gjyqësore, ndër tjerash, përmes publikimit të raportit të votave për dhe kundër një vendimi, për dallim nga sistemi paraprak përmes të cilit vendimmarrja gjyqësore publikohej vetëm përmes shënimit nëse një vendim është marrë përmes votimit njëzëri ose me shumicë, si dhe hapjes për mendime mospajtuese dhe konkurruese të gjyqtarëve në të gjitha kategoritë e vendimmarrjes së Gjykatës, për dallim nga sistemi paraprak ku të njëjtat ishin të mundshme vetëm përkitazi me Aktgjykimet e Gjykatës; (iii) rritja e transparencës dhe llogaridhënies së Gjykatës përmes konsolidimit të parimeve dhe procedurave për qasje në dokumente gjyqësore, duke përfshirë ato konfidenciale; dhe (iv) konsolidimi i mekanizmave të brendshëm për mbikëqyrje sistematike dhe të rregullt të zbatimit të vendimeve të Gjykatës. Në këtë drejtim, Gjykata gjatë vitit 2023, me mbështetjen e Këshillit të Evropës, gjithashtu ka investuar në përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe teknologjike, me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të të gjitha operacioneve, përfshirë atyre të ndërlidhura me vendimmarrjen gjyqësore.


Grupi i dytë i çështjeve i referohet komunikimit të jashtëm të Gjykatës, përfshirë komunikimin dhe bashkëpunimin e saj me gjykatat supranacionale dhe gjykatat ndërkombëtare simotra. Krahas komunikimit të rregullt me publikun përmes publikimit të njoftimeve për vendimmarrje, tri llojeve të raporteve periodike, si dhe adresimit të të gjitha kërkesave për qasje në dokumente publike, Gjykata më 2023 ka shtuar edhe Facebook-un si platformë të komunikimit me qytetarët. Përgjatë këtij viti, ajo gjithashtu ka ndërmarrë aktivitete më qëllim të avancimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të transparencës dhe llogaridhënies. Krahas komunikimit të jashtëm, Gjykata i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe ngritjes së kapaciteteve rreth komunikimit të brendshëm dhe kulturës së saj organizative. Këto përpjekje u kurorëzuan me miratimin e Kartës së Vlerave, si dokument i brendshëm që mëton të bashkërendisë të gjithë punonjësit e Gjykatës në një sistem të përbashkët vlerash dhe parimesh.

Vitit 2023 ka qenë vit i rëndësishëm edhe sa i përket bashkëpunimit dhe afirmimit ndërkombëtarisht të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Gjykata ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me gjykatat simotra anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, si dhe ka zhvilluar shkëmbime profesionale me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Në saje të tashmë traditës së bashkëpunimit me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjyqtarë dhe staf profesional i Gjykatës janë vendosur në Gjykatën e lartcekur për periudha të caktuara. Moment i rëndësishëm ishte sidomos ai i themelimit të Forumit Ballkanik të Gjykatave Kushtetuese, në të cilin Gjykata për herë të parë merr pjesë si bashkëthemeluese dhe anëtare e barabartë me gjykatat tjera

kushtetuese pjesëmarrëse. Përfundimisht, reputacioni i shkëlqyer dhe respekti që gëzon Gjykata në kontekst të drejtësisë kushtetuese, u shfaq më së miri me rastin e shënimit të 14-të vjetorit të themelimit të saj. Me nder e përulësi mirëpritëm në Republikë e Kosovës kryetarë e gjyqtarë të delegacioneve të Gjykatave Kushtetuese dhe të larta nga vende të ndryshme të Evropës dhe më gjerë, si dhe përfaqësues nga Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisionit të Venecias dhe akademikë me renome ndërkombëtare. Përpos Kryetarëve të Gjykatave nga shumë shtete evropiane dhe pjesëmarrësve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjykata gjithashtu u nderua me pjesëmarrjen e Kryetarit të Këshillit Kushtetues të Republikës së Francës, z. Laurent Fabius, duke rezultuar kështu në përforsimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të Gjykatës Kushtetuese me kolegët nga Republika e Francës dhe Gjykatat tjera Kushtetuese frankofone.

Këto të arritura të Gjykatës Kushtetues, të përvijuara si më sipër dhe të paraqitura përmes numrave e statistikave në faqet e këtij Raporti, janë rezultat i punës së palodhshme e përkushtimit të pareshtur të gjyqtarëve të Gjykatës, Këshilltarëve Kushtetues Juridikë, Sekretarit të Përgjithshëm dhe mbarë stafit të Gjykatës. Kjo sinergji është çelësi i një performance që përmbushë mandatin e misionin kushtetues të Gjykatës. Për më tepër, falënderime u dedikohen edhe partnerëve të vazhdueshëm të Gjykatës, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në Këshillin e Evropës, Ambasadën Franceze, Ambasadën Amerikane dhe Agjencinë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar, Ambasadën Gjermane dhe IRZ-në Gjermane. Reflektimi prapa në një vit me të arritura, pavarësisht sfidave, është motivimi më i mirë për të vazhduar punën e përkushtimit të sinqertë drejt mbrojtjes e lartësimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese, vlerave të sundimit të ligjit, demokracisë e shtetit të së drejtës – për qytetarët tanë, për Republikën tonë.

Gresa Caka-Nimani



Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2023

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata apo Gjykata Kushtetuese) është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, si dhe bazuar në Kushtetutë, është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj.

Në vitin 2023, Gjykata Kushtetuese pranoi 294 kërkesa të reja, ndërkaq vendosi për 184 kërkesa. Ndërsa, duke përfshirë edhe lëndët të cilat janë bartur nga vitet e kaluara dhe janë vendosur në vitin 2023, Gjykata publikoi në ueb faqen e saj dhe ua dorëzoi palëve 209 vendime.


Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese u publikuan në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 14 (Seancat administrative) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës e Gjykatës), Gjykata Kushtetuese miratoi raportin e saj vjetor për vitin 2023, më 12 prill 2024.

Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 16 (Sekretaria) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023, Sekretariati gjatë vitit 2023 organizoi mbarëvajtjen e nëntë (9) seancave administrative. Në këto seanca administrative u morën tridhjetë e tre (33) vendime.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2023, ishte e përbërë nga:


Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar;
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare;
Safet Hoxha, gjyqtar;
Radomir Laban, gjyqtar;
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare;
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar;
Enver Peci, gjyqtar.



Gresa Caka-Nimani
Kryetare




Bajram Ljatifi
zëvendëskryetar




**Selvete Gërxhaliu-
Krasniqi**
gjqtare



Safet Hoxha
gjqtar



Remzije Istrefi-Peci
gjqtare



Radomir Laban
gjqtar



Nexhmi Rexhepi
gjqtar



Enver Peci
gjqtar

SEKRETARIA E GJYKATËS KUSHTETUESE

Sekretaria e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 12 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjykatën Kushtetuese) dhe në pajtim me rregullin 16 të Rregullores së punës së Gjykatës, ka kryer punët administrative dhe ka mbështetur punën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Sekretaria udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm i cili, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretarisë.

Struktura organizative e Sekretarisë përbëhet nga:

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;
Departamenti i Administratës dhe i Burimeve Njerëzore (DABNJ);
Departamenti për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (DRLSA);
Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP);
Departamenti për Buxhet dhe Financa (DBF);
Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI);
Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB);
Njësia e Prokurimit (NJP); dhe
Njësia e Teknologjisë së Informacionit, e Komunikimit dhe Multimedive (NJTIKM).

Në realizimin e objektivave të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2021-2025 (në tekstin e mëtejme: Plani Strategjik i Gjykatës 2021-2025), nga **103** aktivitete të parapara për zhvillim gjatë vitit 2023, **89** prej tyre janë realizuar me sukses apo **86.41%**.

Funksionimi i Njesisë Ligjore (NJL), e përbërë nga këshilltarët kushtetues-juridikë dhe personeli tjetër ligjor, si dhe struktura dhe organizimi i saj, janë përcaktuar me Rregulloren e Njesisë Ligjore nr. 03/2019 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Njesisë Ligjore). Këshilltarët kushtetues-juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve.

Gjatë vitit 2023, Sekretaria e Gjykatës ka realizuar këto objektiva:

Implementimi i Planit Strategjik të Gjykatës 2021-2025;
Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2025-2027; dhe
Hartimi i Regjistrimit të Rrezikut për vitin 2023.

Gjatë vitit të kaluar, Sekretaria e Gjykatës gjithashtu publikoi:

- Raportin vjetor të punës për vitin 2022;
- Buletinin informativ nr. 15 (korrik-dhjetor 2022);
- Buletinin informativ nr. 16 (janar-qershor 2023);
- Buletinin e Praktikës Gjyqësore për vitin 2022;
- Buletinin periodik, tetor-dhjetor 2022;
- Buletinin periodik, janar-mars 2023;
- Buletinin periodik, prill-qershor 2023;
- Buletinin periodik, korrik-shtator 2023; si dhe
- Rregulloren e punës nr. 01/2023.

NJËSIA LIGJORE

NJËSIA LIGJORE

Njësia Ligjore është strukturë e veçantë organizative e Gjykatë Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e themeluar në bazë të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, si dhe Rregullores së Njesisë Ligjore Nr. 03/2019. Anëtarët e Njesisë Ligjore i përgjigjen drejtpërdrejt Kryetarit/es dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Roli parësor i Njesisë Ligjore është që të ofrojë mbështetje profesionale për gjyqtarët e Gjykatës duke bërë hulumtime dhe analiza ligjore dhe duke ndihmuar në hartimin e raporteve paraprake, vendimeve si dhe materialit tjetër kushtetues/ligjor, i nevojshëm për punën e Gjykatës. Në këtë drejtim, Njësia Ligjore është përgjegjëse që të ndihmojë Gjykatën drejt sigurimit të një cilësie të lartë të vendimmarrjes dhe të konsistencës së praktikës gjyqësore. Për këto qëllime, Njësia Ligjore, ndër të tjera, kryen hulumtime shteruese ligjore (i) në nivel të së drejtës kombëtare; (ii) të drejtës kushtetuese rajonale dhe ndërkombëtare; (iii) të drejtës ndërkombëtare dhe asaj krahasuese; (iv) të opinioneve, rekomandimeve dhe praktikave të mira të nxjerra nën ombrellën e Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Venecias; (v) praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; dhe, sipas nevojës, edhe të (vi) gjykatave të tjera ndërkombëtare. Po ashtu, Njësia Ligjore (vii) përgatitë materiale të ndryshme për diskutim dhe vendosje përgjatë seancave administrative të Gjykatës si dhe seancave profesionale që mbahen me gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës.

Funksionet e tjera të rëndësishme të Njesisë Ligjore janë: (i) asistimi i Sekretariatit në pritjen e palëve dhe pranimin e kërkesave dhe dokumenteve shtesë; (ii) filtrimi i të gjitha kërkesave të reja të dorëzuara në Gjykatë dhe hartimi i një raporti fillestar filtrues në lidhje me kërkesat e dorëzuara nga palët; (iii) identifikimi i kërkesave me masë të përkohshme dhe urgjencave të tjera që një kërkesë mund të paraqet varësisht nga natyra e rastit (iv) mbajtja dhe përditësimi i bazave të dhënave siç janë: baza e të dhënave e llojit të kërkesave dhe pretendimeve të ngritura; baza e të dhënave për zbatimin e vendimeve të Gjykatës; dhe po ashtu baza e të dhënave për përcjelljen e gjendjes së secilit rast që nga fillimi e deri në publikimin e tij. Të gjitha vendimet e Gjykatës klasifikohen sipas sistemit të filtrimit nga Njësia Ligjore para publikimit në ueb faqen e Gjykatës sipas kriterëve të paracaktuara me qëllim të ofrimit të mundësisë për një kërkim më të lehtë shkencor, profesional dhe akademik për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe komunitetin juridik që i qasen vendimeve përmes ueb faqes së saj.

Njësia Ligjore përbëhet nga: Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik; Juriskonsulti; Zëvendës Këshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët Kushtetues Juridikë dhe Këshilltari i Lartë për Administrimin e Kërkesave. Aktualisht, Njësia Ligjore përbëhet nga 15 anëtarë dhe udhëhiqet dhe mbikëqyret nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik i cili ndihmohet nga dy Zëvendës Këshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë. Që të tre këta, si dhe Juriskonsulti, zgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës nga radha e këshilltarëve të lartë kushtetues juridikë për një periudhë 3 (tri) vjeçare. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik, ndër të tjera, ndihmon dhe këshillon Gjykatën në kryerjen e funksioneve të saj; mbështetë të gjithë anëtarët e Njesisë Ligjore në kryerjen e detyrave të tyre, mbikëqyr organizimin, aktivitetin dhe performancën e anëtarëve të Njesisë ligjore, si dhe në draftimin e raporteve paraprake dhe kryerjen detyrave të tjera. Ndërsa roli i Juriskonsultit është që të këshillojë Gjykatën dhe ta njoftojë atë për çështje të ndryshme që ndërlidhen me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe praktikën e re të GJEDNJ-së me synim të sigurimit të konsistencës së praktikës gjyqësore. Në bashkërendim me Këshilltarin e Parë Kushtetues Juridik, Juriskonsulti ndihmon dhe propozon rekomandime përkatëse me qëllim të sigurimit të cilësisë së lartë të vendimmarrjes dhe konsistencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës.

Anëtarët e Njesisë Ligjore kanë role specifike të krijuara për nevojat e Gjykatës. Ata kanë statusin e të punësuarit me kohë të pacaktuar dhe kushtet specifike të punës dhe përshkrimet

e sakta të detyrave të tyre të tyre të punës janë të përcaktuara me Ligjin për Gjykatën, Rregulloren e punës dhe Rregulloren për Njësinë Ligjore. Në ofrimin e këshillave që ndërlihet me vendimmarrjen e Gjykatës, anëtarët e Njësisë Ligjore janë të pavarur dhe të lirë për të shprehur mendimin e tyre profesional në lidhje me çdo kërkesë në të cilën ata punojnë.

Njësia Ligjore mban takime të rregullta lidhur me organizimin e punës së saj, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në: (i) përcjelljen e statusit të rasteve; (ii) diskutimin e çështjeve të ndryshme juridiko-kushtetuese; (iii) propozimin e akteve të brendshme të Gjykatës; si dhe (iv) diskutimin rreth praktikës gjyqësore të vet Gjykatës por edhe të GJEDNJ-së. Faktor i rëndësishëm në sigurimin e vendimmarrjes efikase juridike dhe të ngritjes së cilësisë së hartimit të raporteve dhe të vendimeve është trajnimi profesional i këshilltarëve të Gjykatës në fushën e së drejtës kushtetuese, ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut. Në kuadër të aktiviteteve të Gjykatës, anëtarët e Njësisë Ligjore kanë marrë pjesë në punëtori profesionale gjatë tërë vitit. Lista e plotë e aktiviteteve të këshilltarëve juridikë mund të gjendet në Pjesën e këtij raporti - Aktivitetet e Gjykatës.

Gjatë vitit 2023, Njësia Ligjore ka arritur që të përmbushë të gjitha detyrat e saj drejt ofrimit të mbështetjes së gjyqtarëve gjatë përgatitjes, shqyrtimit dhe vendimmarrjes në lidhje me rastet e referuara në Gjykatë.

Gjatë këtij viti janë trajtuar një numër i lartë i rasteve, disa prej tyre të një kompleksiteti të lartë dhe me ndikimin në praktikë gjyqësore të Gjykatës, në të cilat Njësia Ligjore ka dhënë kontribut të vazhdueshëm dhe përmbajtësor në procesin e analizimit të rasteve, përgatitjes së hulumtimeve ligjore dhe hartimit të vendimeve, bazuar në vendimmarrjen e gjyqtarëve të Gjykatës.

Njësia Ligjore vazhdon të jetë e përkushtuar në ngritjen e profesionalizmit të saj, nëpërmjet realizimit të projekteve të ndryshme që ofrohen dhe mundësohen nga partnerët strategjikë të Gjykatës Kushtetuese. Në vazhdimësi dhe përgjatë gjithë vitit, Gjykata Kushtetuese është e hapur për të ofruar takime me studentë dhe grupe të tjera të interesuara, me qëllim që të njoftojë të gjithë të interesuarit lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese, rolin e saj të përcaktuar me Kushtetutë si dhe kërkesat që paraqiten pranë saj.

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE
NJERËZORE**

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE

I. Burimet njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

Gjatë vitit 2023, DABNJ në zbatim të planit të punës, mbështeti mbarëvajtjen e punës së Sekretarisë në përputhje me mandatin e saj.

Gjatë kësaj periudhe, në përputhje me shënimet e personelit u ndërmorën këto aktivitete:

Në kuadër të raportimit dhe organizimit të punës janë hartuar dhe dorëzuar:

- Raporti vjetor i të punësuarve për vitin 2022;
- Plani i rekrutimit për vitin 2023;
- Plani trevjeçar i trajnimeve;
- Raporti vjetor i DABNJ-së për vitin 2022;
- Buxhetimi gjinor i stafit të GJKK-së;
- Indikatorët e performancës për periudhën janar-maj 2023.

Organizimi i tetë (8) konkurseve të jashtme për plotësimin e dhjetë (10) pozitave:

- Një (1) Zyrtar Certifikues, e cila është plotësuar më 24 prill 2023;
- Një (1) Zyrtar për Prokurim, e cila ka rezultuar pa kandidatë të suksesshëm;
- Një (1) Zyrtar për Protokoll, e cila është plotësuar me datë 1 qershor 2023;
- Një (1) Drejtor i Njësisë së Prokurimit, e cila është plotësuar me 1 shtator 2023;
- Një (1) Zëvendësim i përkohshëm i pozitës Menaxher i Zyrës në Kabinet, e cila është plotësuar më 18 shtator 2023;
- Tre (3) Këshilltarë Kushtetues Juridikë, që ka rezultuar pa kandidatë të suksesshëm;
- Një (1) Përkthyes nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas, e cila gjendet në fazë të vlerësimit; dhe
- Një (1) Receptonist/e, e cila gjithashtu gjendet në fazë të vlerësimit.

Organizimi i dy (2) procedurave të avancimit, përmes konkurseve të brendshme për plotësimin e pozitave: 1 (një) Drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe 1 (një) Certifikues, me ç'rast bazuar në rezultatin e procedurës së rekrutimit, vetëm pozita e Drejtorit të Përkrahjes Profesionale është përfunduar me kandidat të suksesshëm, ndërsa pozita Certifikues është anuluar dhe shpallur me konkurs të jashtëm.

Angazhimi i Praktikantëve:

Pranimi dhe vlerësimi i dy (2) kërkesave për angazhim të praktikantëve ndërkombëtarë;

Organizimi i shprehjes së interesit për angazhimin e një (1) Praktikanti për multimedia dhe ueb faqe, e cila u plotësua më 1 gusht 2023;

Organizimi i shprehjes së interesit për angazhimin e gjashtë (6) Praktikantëve për periudhë një (1) vjeçare. Përzgjedhja e gjashtë kandidatëve është bërë në fund të vitit 2023 ndërsa puna praktike do të filloj në janar të vitit 2024.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar tri (3) procedura të vlerësimit të periudhës provuese, me ç'rast është konfirmuar kalimi me sukses i periudhës provuese.

Sa i përket mbështetjes së procesit të procedurave të rekrutimit dhe avancimit, DABNJ ka ofruar të gjitha shërbimet mbështetëse përkatësisht menaxhimin e procedurave të rekrutimit: regjistrimin e aplikacioneve, draftimin e Vendimeve për formimin e Komisionit Përzgjedhës, përgatitjen e formularëve përkatës, procedimin e ftesave/njoftimeve, organizimin e testeve dhe intervistave, hartimin e raporteve finale, përgatitjen e përgjigjeve në ankesa e deri në komunikim të rezultateve.

Katër (4) zyrtarë të GJKK-së mbushën dhjetë (10) vite punë të pandërprerë në Gjykatën Kushtetuese gjatë vitit 2023.

Janë përgatitur dhe ofruar akt-emërime, kontrata të punës, vendime për përfundim të marrëdhënies së punës, Vendime për grupe punuese, Vendime për themelimin e Komisioneve Përzgjedhëse, Vendime për përdorim të veturave zyrtare, Vendime për pushime prindërore, Certifikata, Mirënjohje dhe Vërtetime të dëshmisë së punësimit sipas kërkesave të zyrtarëve. Në baza të rregullta është evidencuar vijueshmëria e stafit si dhe është bërë përditësimi i evidencës së pushimeve vjetore dhe mjekësore.

Në kuadër të zbatimit të kërkesave nga seancat administrative dhe planit të veprimit të Planit Strategjik, janë zhvilluar këto aktivitete:

Janë formuar katër (4) grupe punuese në kuadër të ndryshimeve në rregullativën e brendshme dhe aktiviteteve të parapara me Planin e Veprimit të Planit Strategjik;
Janë nxjerr shtatë (7) rregullore të brendshme dhe një (1) udhëzues administrativ;
Është zhvilluar softuerit elektronik për menaxhimin e burimeve njerëzore, asete dhe depo;

Gjatë këtij viti, për sa i përket pushimeve të veçanta një (1) zyrtarë e GJKK-së ka shfrytëzuar pushimin pa pagesë, kurse gjashtë (6) zyrtarë kanë shfrytëzuar pushimin prindëror me 70% të pagës, ndërsa një (1) zyrtarë e emëruar në funksion publik vazhdon të ushtrojë të drejtën e pezullimit të dakorduar të marrëdhënies së punës.

Sa i përket zbatimit të Planit Strategjik, janë mbajtur dy Punëtori lidhur me zbatimin e planit të veprimit të planit strategjik 2023 si dhe Regjistrin e Rrezikut.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, të kuadër të ndryshimeve në listën e pagave dhe të dhënave statistikore përgjatë vitit 2023, janë:

- Gjashtë (6) punonjës të ri;
- Dy (2) dorëheqje;
- Një (1) përfundim i marrëdhënies së punës me pensionim;
- Pesë (5) pushime prindërore;
- Një (1) pushim pa pagesë;
- Një (1) pezullim i dakorduar.

Nga numri i përgjithshëm prej 70 (shtatëdhjetë) punëtorë të lejuar me buxhetin e vitit 2023, në fund të kësaj periudhe, numri i përgjithshëm i të punësuarve në listën e pagave të muajit dhjetor 2023 është 63 të punësuar, prej të cilëve:

Numri i të punësuarve sipas gjinisë:

- 33 apo 52%, të gjinisë femërore;
- 30 apo 48%, janë të gjinisë mashkullore.

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë etnike:

- 58 apo 92.06% janë shqiptarë;

- 2 apo 3.17% janë serbë;
- 2 apo 3.17% janë boshnjak; dhe
- 1 apo 1.59% malazias.

Figura nr. 1: Numri i të punësuarve sipas përkatësisë etnike:





Figura nr.2: Numri i të punësuarve sipas gjinisë



Ngritja e kapaciteteve (trajnimet dhe zhvillimi i karrierës)

Gjatë vitit 2023 DABNJ zbatoi planin trevjeçar të trajnimeve për periudhën 2022-2024, si dhe në vazhdimësi janë përditësuar dhe evidentuar të gjitha aktivitetet e stafit gjatë këtij viti. Gjithsej u realizuan 46 aktivitete, si në vijim:

- Gjashtë (6) konferenca ndërkombëtare;
- Pesë (5) shkëmbime përvojash;
- Dy (2) forume rajonale/ballkanike;

- Një (1) takim ndërkombëtar;
- Një (1) kongres botëror;
- Një (1) vizitë studimore;
- Dy (2) vizita zyrtare;
- Një (1) shkollë verore;
- Një (1) punëtori jashtë vendit;
- Nëntë (9) punëtori brenda vendit;
- Pesë (5) trajnime jashtë vendit;
- Njëmbëdhjetë (11) trajnime brenda vendi;
- Një (1) seminar jashtë vendit.

Në vijim paraqesim të dhënat e aktiviteteve të realizuara sipas kronologjisë:


- Më 9-27 janar 2023, në Hagë të Holandës është realizuar pjesëmarrja në sesionin dimëror të kurseve për të drejtën ndërkombëtare, organizuar nga Akademia e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare, me një (1) pjesëmarrës;
- Më 5-18 janar 2023, në Prishtinë, është realizuar trajnimi themelor mbi njohuritë e Prokurimit Publik, me një (1) pjesëmarrës;
- Më 19-22 janar 2023, në Budvë të Malit të Zi, është mbajtur punëtorja me temën “Punëtori orientuese për gjyqtarin e ri”, organizuar nga Këshilli i Evropës, me tridhjetë (30) pjesëmarrës;
- Më 30 janar – 3 shkurt 2023, në Lisbonë të Portugalisë u realizua vizitë zyrtare, organizuar nga Këshilli i Evropës, në të cilën morën pjesë trembëdhjetë (13) pjesëmarrës;
- Më 2-3 shkurt 2023, në Mitrovicë, u realizua trajnimi për përkthim dhe interpret organizuar nga Zyra e Komisionarit për Gjuhë, me një (1) pjesëmarrës;
- Më 21 shkurt 2023, në Prishtinë, u realizua trajnimi me zyrtarët kontaktues në lidhje me deklarin e pasurisë, organizuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me gjithsej një (1) pjesëmarrës;
- Nga 27 shkurt deri 27 prill 2023, me mbështetje të Këshillit të Evropës, një (1) Këshilltar Kushtetues, ka qëndruar në Gjykatën e Strasburgut për 2 muaj të plotë, me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;
- Gjatë muajit mars 2023, për rreth tre javë, Kryetarja e Gjykatës, me mbështetje të Këshillit të Evropës, ka realizuar vizitën në Gjykatën e Strasburgut, me qëllim të shkëmbimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;
- Më 15-17 mars 2023, në Durrës të Shqipërisë, u mbajt punëtorja e parë në lidhje me Zbatimin e Planit të Veprimit të Planit Strategjik për vitin 2023, organizuar nga grupi punues, me dymbëdhjetë (12) pjesëmarrës;
- Më 23 mars 2023, në Prishtinë, u mbajt punëtorja me temën “Planifikimi i Keshit” organizuar nga Ministria e Financave, me një (1) pjesëmarrës;

- Më 26-29 mars 2023, në Luksemburg, u realizua vizitë zyrtare, organizuar nga Gjykata Kushtetuese, në të cilën morën pjesë nëntë (9) pjesëmarrës;
- Nga 2 prill deri më 3 maj 2023 me mbështetje të Këshillit të Evropës, një (1) Këshilltare e Lartë Ligjore ka qëndruar në Gjykatën e Strasburgut për një (1) muaj të plotë, me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;
- Më 13 prill 2023, në Prishtinë, është mbajtur trajnimi “Menaxhimi i kontratave të prokurimit”, i organizuar nga KRPP, me dhjetë (10) pjesëmarrës nga gjykata;
- Nga 23 deri 26 prill 2023, në Sofje të Bullgarisë, është mbajtur “Takimi i 20 vjetorit të Këshillit të Përbashkët të Drejtësisë Kushtetuese të Komisionit të Venecias”, i mbështetur nga Këshilli i Evropës, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës nga gjykata;
- Nga 4 deri 7 maj 2023, në Grac të Austrisë, është mbajtur konferenca ndërkombëtare në të cilën mori pjesë Kryetarja me ligjërim të temës “Sundimi i Ligjit dhe roli i Gjykatës Kushtetuese”;
- Nga 9 deri 10 maj 2023, në Tiranë, me ftesë të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, Kryetarja mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me rastin e shënimit të 110 vjetorit të Gjykatës së Lartë me titull “Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti kombëtar tek vlerat universale”;
- Më 25-26 maj 2023, në Prishtinë, është mbajtur trajnimi me temën “Etika në administratën publike (Parandalimi i konfliktit të interesit dhe korrupsionit)”, organizuar nga IKAP, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës nga gjykata;
- Më 25-31 maj 2023, në Prishtinë, u organizuar trajnimi “Moduli i shpenzimeve” organizuar nga Thesari-Ministria e Financave, në të cilën mori pjesë një (1) pjesëmarrës nga gjykata;
- Më 9 qershor 2023, në Gjakovë, u organizua punëtori e përbashkët e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese me Gjyqtarë të Gjykatave Themelore të Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit, organizuar dhe mbështetur nga Këshilli i Evropës, në të cilën morën pjesë gjithsej shtatë (7) pjesëmarrës nga gjykata;
- Më 10-17 qershor 2023, në Hagë të Holandës, është mbajtur programi i trajnimit me temën “Të drejtat e njeriut dhe minoriteteve”, organizuar nga MATRA dhe mbështetur nga Ministria e punëve të jashtme të Holandës, në të cilin mori pjesë një (1) përfaqësues;
- Më 23 qershor, ka filluar vazhdimi i kursit të gjuhës frënge, organizuar nga Aleanca Franceze;
- Më 30 qershor 2023, në Prishtinë, është mbajtur trajnimi me temën “Prezantimi i Planit Kontabël të Përditësuar dhe Udhëzuesit të Planit Kontabël”, organizuar nga Thesari-Ministria e Financave, në të cilin mori pjesë një (1) pjesëmarrës nga gjykata.
- Më 3-7 korrik 2023 me mbështetje të Unionit të Evropës-CEF, në Lubjanë të Sllovenisë, një (1) Këshilltar i Lartë Ligjor mori pjesë në trajnimin me temën “We lead - Jumbo Meeting”.
- Më 10-13 korrik 2023, u realizua vizita studimore në Këshillin Shtetëror të Francës, në të cilën mori pjesë një (1) gjyqtar nga gjykata;

- Më 10-12 korrik 2023, në Prevallë, është mbajtur punëtorja rreth “Komunikimit të Brendshëm”, e mbështetur nga USAID, në të cilën morën pjesë tridhjetë (30) pjesëmarrës nga gjykata;
- Më 17-24 korrik 2023, në Nju Jork të SHBA-ve, është mbajtur kongresi botëror i drejtësisë, në të cilën morën pjesë dy (2) gjyqtare nga gjykata;
- Më 17-20 korrik 2023, në Selanik të Greqisë, organizua punëtori e përbashkët e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese me Gjykatën Supreme organizuar dhe mbështetur nga IRZ, në të cilën morën pjesë gjithsej trembëdhjetë (13) pjesëmarrës nga gjykata;
- Më 8-9 shtator 2023, në Prevallë është mbajtur punëtorja për Hartimin e Planit të ri të Veprimit të Planit Strategjik për vitet 2024-2025, organizuar dhe mbështetur nga Këshilli i Evropës, në të cilën morën pjesë gjithsej njëzet e një (21) pjesëmarrës nga gjykata;
- Më 18-22 shtator 2023, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, 2 (dy) pjesëmarrës nga gjykata kanë marrë pjesë në Shkollën Verore, e cila është realizuar në Ankara.
- Më 18 shtator 2023, në Prishtinë, është mbajtur trajnimi me temën “Arsyetimi i vendimeve dhe të drejtat e njeriut”, organizuar dhe mbështetur nga Këshilli i Evropës, në të cilën morën pjesë gjithsej njëmbëdhjetë (11) pjesëmarrës nga gjykata;
- Më 19-20 shtator 2023, në Prishtinë, është mbajtur trajnimi për trajner i organizuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, në të cilin morën pjesë tre (3) pjesëmarrës nga gjykata;
- Më 20 shtator 2023, në Prishtinë, është mbajtur punëtorja me temën “Rëndësia e Parandalimit të Konfliktit të Interesit, Roli i Autoriteteve Përgjegjëse sipas Legjislacionit Kosovar dhe Praktikrat rajonale dhe ndërkombëtare”, organizuar dhe mbështetur nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit;
- Më 21-23 shtator 2023, në Londër, është mbajtur seminari me temën “Notre Dame Seminar on Constitutional and Rule of Law”, në të cilën mori pjesë një (1) përfaqësues nga gjykata;
- Më 26-27 shtator 2023, në Prishtinë është mbajtur trajnimi me temën “Plani kontabël dhe kontabiliteti në SIMFK” organizuar nga IKAP, në të cilën mori pjesë një (1) përfaqësues nga gjykata.
- Më 20 tetor 2023, në Prishtinë është mbajtur punëtorja me temën “Si të hartohet një Plan i Integritetit”, i organizuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me 1 pjesëmarrës;
- Më 24-25 tetor 2023, nga Gjykata Kushtetuese është organizuar konferenca ndërkombëtare me temën “The Contribution of Constitutional Courts in Protecting and Strengthening Fundamental Values of Democracy, Rule of Law, and Fundamental Human Rights and Freedoms”, në Prishtinë, me gjithsej 38 pjesëmarrës, duke përfshirë këtu edhe stafin mbështetës;
- Më 27 tetor 2023, në Bullgari është mbajtur Forumi Ballkanik i Gjykatave Kushtetuese, me 4 pjesëmarrës nga gjykata;
- Më 3 nëntor 2023, në Prishtinë është mbajtur trajnimi me temën “Mbrojtja gjyqësore e të drejtës për liri të shprehjes online”, me gjithsej 11 pjesëmarrës, aktivitet ky i mbështetur nga Këshilli i Evropës;

- Më 8-10 nëntor 2023, në Sarajevë të Bosnjës, është mbajtur Forumi i 10-të Rajonal i Evropës Juglindore për Sundimin e Ligjit, i organizuar nga Këshilli i Evropës, me 1 pjesëmarrës;
- Nga 13 nëntor deri më 8 dhjetor 2023, në Strasburg të Francës janë realizuar dy shkëmbime përvojash, mbështetur nga Këshilli i Evropës, me 2 pjesëmarrës;
- Më 26-29 nëntor 2023, në Shqipëri është mbajtur trajnimi me temën “Shkrimi cilësor në Auditim”, me 1 pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 26- 29 nëntor 2023, në Shqipëri, është mbajtur trajnimi me temën “Menaxhimi i Financave Publike dhe Kontabiliteti në Sektorin Publik”, me 1 pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 26-28 nëntor 2023, në Shqipëri është mbajtur Konferenca Ndërkombëtare e përvjetorit jubilar të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, me 2 pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 5-7 nëntor 2023, në Londër është mbajtur konferenca “Internal Audit Conference 2023”, me 2 pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 14 dhjetor në Prishtinë, është mbajtur një Konferencë me IRZ, me gjithsej 28 pjesëmarrës;
- Më 18-19 dhjetor 2023, në Prishtinë është mbajtur trajnimi “Konventa e Stambollit dhe referimi në Vendimet e GJEDNJ-së”, i mbështetur nga Këshilli i Evropës, me gjithsej 13 pjesëmarrës.

Figura nr. 3: Pjesëmarrja e stafit të Gjykatës Kushtetuese në vizita studimore, konferenca dhe shkolla verore jashtë vendit, konferenca/punëtori brenda dhe jashtë vendit, trajnime brenda dhe jashtë vendit, kurse të gjuhëve të huaja:



Mbështetja administrative dhe logjistike

DABNJ ka siguruar ofrimin e shërbimeve administrative dhe të shërbimeve tjera që ndihmojnë në kryerjen dhe shtimin e efikasitetit në punë për gjithë stafin e Gjykatës:
Është organizuar dhe bërë pranimi dhe shpërndarja e inventarit për të punësuarit e ri dhe janë furnizuar të gjithë të punësuarit në Gjykatë me pajisje të nevojshme të TI-së;
Është bërë regjistrimi, mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt i veturave të Gjykatës dhe përpilimi i raporteve të veçanta për shpenzimet e derivateve;
Është kryer kontrolli i hyrje-daljeve të materialit shpenzues dhe pajisjeve të TI-së, si dhe është bërë regjistrimi i tij në Sistemin e Menaxhimit të Informatave të E-pasurisë;
Pas furnizimit me material shpenzues dhe të pajisjeve të TI-së, si dhe shërbimeve për nevoja pune të GJKK-së, është bërë regjistrimi i **188** faturave në Sistemin Free Balance;
Janë përpiluar raporte të veçanta lidhur me ngarkimin apo shkarkimin me pajisje pune për të punësuarit e GJKK-ës.

Biblioteka e Gjykatës (Shërbimet e bibliotekës)

Nga fusha e bibliotekës janë kryer këto aktivitete, përkatësisht është pranuar dhe regjistruar kjo literaturë:

Ka vazhduar anëtarësimi vjetor i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK), përmes së cilit ofrohet qasja në këto burime elektronike: Cambridge Journals Online, Edward Elgar Publishing, IMF- International Monetary Fund, Open Edition Journals, ASTM- Compass;

Janë pranuar dhe regjistruar në sistemin elektronik, titujt në vijim:

- ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, 2022, volume 16 issue 4;
- ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, 2023, volume 17 issue 1;
- ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, 2023, volume 17 issue 2;
- “Gjyqtar dhe Avokat”, nga autori Hasan Hoti;
- Roli i Gjykatave Kushtetuese në Demokracitë e Reja.

**DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE,
STATISTIKËS DHE ARKIVIT**

DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT

Statusi i lëndëve

Gjatë vitit 2023, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 473 kërkesa/lëndë, nga të cilat 294 janë pranuar dhe 179 janë bartur nga vitet e kaluara:

22 kërkesa të bartura nga viti 2021 janë zgjidhur;

157 kërkesa janë bartur nga viti 2022, prej të cilave 112 janë zgjidhur, ndërsa në proces janë 45 kërkesa;

294 kërkesa janë pranuar në vitin 2023, prej të cilave 50 janë zgjidhur dhe në proces janë 244 kërkesa.


Në këtë periudhë, 184 kërkesa janë zgjidhur ose 39% e kërkesave që gjykata ka pasur në punë gjatë vitit 2023.

Gjatë kësaj periudhe, 209 vendime janë publikuar në ueb faqen e Gjykatës dhe janë përcjellë tek palët, ndërsa 4 të tjera të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.

Gjatë periudhës në fjalë, mesatarisht janë pranuar 24,5 kërkesa në muaj, ndërsa janë zgjidhur 15,3.

Dinamika mujore e kërkesave të pranuar dhe të zgjidhura është si në vijim:

Figura nr. 4: Dinamika e kërkesave sipas muajve (1 janar – 31 dhjetor 2023)



Struktura e parashtresve të kërkesave


Juridiksioni dhe palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese janë përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Besimi i qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese është rritur dukshëm si rezultat i punës efektive dhe të paanshme. Departamenti për Regjistrimin e Lëndëve, Statistikës dhe Arkivit gjatë vitit 2023, ka pranuar 294 kërkesa të reja.

Struktura e kërkesave të parashtruara është:

241 kërkesa kanë qenë individuale (nga personat fizikë), ose 82 %,
34 kërkesa nga organizata punuese (personat juridikë), ose 11,6%, dhe
19 kërkesa nga autoritetet publike (institucionet), ose 6,5%,

Figura nr. 5: Struktura parashtresve të kërkesave (1 janar – 31 dhjetor 2023)



Shpërndarja e kërkesave

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, DRLSA i ka proceduar të gjitha kërkesat e parashtruara sipas nenit 113 të Kushtetutës.

Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për Gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullin 10 dhe 35 të Rregullores së punës të Gjykatës. Përfundim nga ky rregull është shpërndarja e kërkesave për vënien e Masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 44 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, dhe rastet *ad hoc*, të cilat paraqesin konflikt të interesit në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Gjykatat dhe në pajtim me rregullin 38 të Rregullores së punës.


Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës

Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht përkatësisë etnike, fetare apo gjinore, kanë qasje të barabartë në Gjykatën Kushtetuese.

Qasja etnike e individëve tregohet si në vijim:

- 223 kërkesa nga shqiptarët, ose 92,5 %;
- 15 kërkesa nga komuniteti serb, ose 6,2 %;
- 3 kërkesa nga komunitetet të tjera, ose 1,2 % dhe


Figura nr. 6: Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave (1 janar – 31 dhjetor 2023)



Struktura gjinore e parashtruesve të kërkesave tregohet si në vijim:

- 35 kërkesa të parashtruara nga gjinia femërore, ose 14,5%;
- 189 kërkesa të parashtruara nga gjinia mashkullore, ose 78,4%;
- 17 kërkesa të parashtruara në grup, ose 7,1%.

Figura nr. 7: Struktura e parashtruesve të kërkesave (1 janar – 31 dhjetor 2023)




Tipologjia e shkeljeve të supozuara

Tipologjia e shkeljeve të supozuara lidhur me 294 kërkesat e pranuar gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2023, është si në vijim:

- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës], 9.4%
- Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 2.2%
- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32.2%
- Neni 24 [Barazia para Ligjit], 12.7%
- Neni 21 [Parimet e Përgjithshme], 2.1%
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 3.4%
- Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], 2.1%
- Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 1.6%
- Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 1.3%
- Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 7.3%
- Neni 36 [E Drejta e Privatësisë], 0.3%
- Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 0.1%
- Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 1.6%
- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 9.5%
- Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 1.6%
- Neni 3 [Barazia para Ligjit], 3%
- Neni 7 [Vlerat], 1.9%
- Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], 1.3%
- Neni 119 [Parimet e Përgjithshme], 0.4%
- Neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme], 0.3%
- Shkelje të tjera, 5.2%


Grafikoni nr. 5 Tipologjia e shkeljeve të supozuara të neneve të Gjykatës Kushtetuese (01 janar – 31 dhjetor 2023)



Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

273 kërkesa ose 92,9 % e tyre kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave,
21 kërkesa ose 7,1 % e kërkesave kanë të bëjnë me Autoritetet tjera publike.

Figura nr. 8: Shkelësit e supozuar të së drejtave (1 janar – 31 dhjetor 2023)




Afati i zgjidhjes së kërkesave

Gjatë vitit 2023, Gjykata Kushtetuese ka publikuar 209 vendime.

Grafikoni në vijim pasqyron dinamikën e afatit të zgjidhjes dhe publikimit të kërkesave sipas muajve dhe ditëve, i cili variron prej 5 muajve në 19 muaj ose shprehur në ditë nga 153 ditë në 572 ditë.

Figura nr. 9: Afati i zgjidhjes së kërkesave (1 janar – 31 dhjetor 2023)



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese


Gjatë vitit 2023, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 40 seanca plenare, me 227 kolegje shqyrtuese.

Rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime për papranueshmëri, vendim për masë të përkohshme, vendime për tërheqje të kërkesës, vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër dhe Urdhra të tjerë.

Struktura e 209 vendimeve të publikuar gjatë periudhës në fjalë është si në vijim:

- 33 Aktgjykime;
- 147 Aktvendime për papranueshmëri;
- 10 Refuzim i kërkesës me procedurë të shkurtër;
- 1 Vendim për tërheqje të kërkesës;
- 2 Vendime për Masë të Përkohshme;
- 16 Urdhra të tjerë.

Figura nr. 10: Struktura e vendimeve të publikuara (1 janar – 31 dhjetor 2023)



Në vitin 2023, Gjykata Kushtetuese ka publikuar 33 aktgjykime:

Aktgjykim në rastin KI108/22, Parashtrues: “Metalinvest S.H.A.”, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC–I–19–0213] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 16 marsit 2022;

Aktgjykim në rastin KI129/21, Parashtrues: Velerda Sopi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “veprimeve dhe mosveprimeve” të Gjykatës Themelore në Gjilan, Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë;

Aktgjykim në rastin KI185/21, Parashtrues: SHPK “CO COLINA”, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [ARJ. UZVP. nr. 83/2021], të 7 shtatorit 2021;

Aktgjykim në rastin KI36/22, Parashtrues: “MATKOS GROUP” sh.p.k., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ. nr. 116/2021] të 28 tetorit 2021;

Aktgjykim në rastin KI06/21, Parashtrues: Dragan Mihajloviq, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurave në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, përkitazi me lëndën Ac. nr. 3930/2016;

Aktgjykim në rastin KI143/22, Parashtrues: Hidroenergji sh.p.k., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ. UZVP. nr. 51/2022], të datës 19 korrik 2022;

Aktgjykim në rastin KO190/19, Parashtrues: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpaques sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve;

Aktgjykim në rastin KI214/21, Parashtrues: Avni Kastrati, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ. nr. 84/2021] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 22 shtatorit 2021;

Aktgjykim në rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22, Parashtrues të kërkesës KO100/22, Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Parashtrues të kërkesës KO101/22, Arben Gashi dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

Aktgjykim në rastin KI14/22, Parashtrues: Shpresa Gërvalla, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 409/2020 të 28 shtatorit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës;

Aktgjykim në rastin KI67/22, Parashtrues: Zeqirja Prebreza, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit CA. Nr. 1343/2021 të 29 dhjetorit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës;

Aktgjykim në rastin KI41/22, Parashtrues: Shkumbin Qehaja, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-21-0867-A001, të 10 marsit 2022 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës;

Aktgjykim në rastin KI85/22, Parashtrues: Jadran Kostić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit 2022:19820 të 17 majit 2022 të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Aktvendimit Pn1 nr. 704/2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të 31 majit 2022;

Aktgjykim në rastin KI69/21, Parashtrues: Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AA. nr. 29/2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 12 marsit 2021;

Aktgjykim në rastin KO139/21, Parashtrues: Fadil Nura dhe 9 deputetë tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës të 21 korrikut 2021 për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave;

Aktgjykim në rastin KI212/21, Parashtrues: Behar Emini, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 382/2021 të 22 shtatorit 2021

Aktgjykim në rastin KI82/22, Parashtrues: Valon Loxhaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 103/2022 të 30 marsit 2022

Aktgjykim në rastin KO159/21 dhe KO160/21, Parashtrues: Komuna e Prishtinës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Raportit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nr. 020-558/17 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të 12 korrikut 2021, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Raportit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nr. 020-558/10 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të 8 korrikut 2021”;

Aktgjykim në rastin KO164/21, Parashtrues: Komuna e Prishtinës- Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 6, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.151/2020, i 22 dhjetorit 2020 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;

Aktgjykim në rastin KI55/22, Parashtrues: Sasha Spasiq Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [2022:19820], të 17 majit 2022 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Pn1. Nr. 704/2022] të 31 majit 2022;

Aktgjykim në rastin KO207/22, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësimi i amendamentit të propozuar të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të propozuar

nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 24 dhjetor 2022, me shkresën nr. 08/3198/DO-1347/1;

Aktgjykim në rastin KI161/21, Parashtrues: Suzana Zogëjani Sekiraqa, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 310/2020 të 28 prillit 2021;

Aktgjykim në rastin KI129/22, Parashtrues: Saša Milosavljević, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj 2022:19820 të 12 gushtit 2022 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Pn1. nr. 1109/2022 të 5 shtatorit 2022;

Aktgjykim në rastin KI122/21, Parashtrues: Lekë Bytyqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [CPP. nr. 1/2021], të 10 marsit 2021;

Aktgjykim në rastin KI206/21, Parashtrues: Ukë Salih, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 584/2020] të 22 prillit 2021;

Aktgjykim në rastin KO134/21, Parashtrues: Ramush Haradinaj dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-036 të 8 korrikut 2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Aktgjykim në rastin KO216/22 dhe KO220/22, Parashtrues të kërkesës: KO216/22, Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës; KO220/22, Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Aktgjykim në rastin KI64/23, Parashtrues: Mejrem Qehaja Rexha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së tezgjatjes së procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Gjakovë, përkritazi me lëndën [C. nr. 546/18];

Aktgjykim në rastin KI21/23, Parashtrues: “Kelkos Energy” sh.p.k. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ. UZVP. nr. 119/22] të 16 dhjetorit 2022;

Aktgjykim në rastin KI90/23, Parashtrues: Shqipdon Fazliu, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ.nr.114/2022] të 23 dhjetorit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ndërlidhur me Aktvendimin [AA.nr.650/2022] e 1 shtatorit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [A.nr.1875/22] e 2 gushtit 2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë;

Aktgjykim në rastin KO177/23, Parashtrues: Komuna e Prizrenit, vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 5 të Ligjit nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme;

Aktgjykim në rastin KO173/22, Parashtrues: Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg;

Aktgjykim në rastin KI74/22, Parashtrues: Zoran Đokić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Pml.nr.19/2022], të 15 shkurtit 2022;

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE

Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit, redaktimit, lekturës dhe harmonizimit të terminologjisë në të gjitha dokumentet e Gjykatës Kushtetuese në gjuhët në të cilat punon GJKK-ja.

DPP-ja ka organizuar, udhëhequr dhe mbikëqyrur punën e përkthimit (në gjuhën shqipe, serbe, angleze dhe frënge edhe për ueb faqen zyrtare të Gjykatës), redaktimit, lekturës dhe përkthimit aty për aty (në gjuhën shqipe, gjuhën serbe dhe gjuhën angleze). Kështu që, nëpër DPP kanë kaluar 42632.7 faqe të shkresave, dokumenteve të ndryshme, aktgjykimeve, aktvendimeve, vendimeve për heqje nga lista, raporteve paraprake e të tjera në gjuhën shqipe, gjuhën serbe, gjuhën angleze dhe në gjuhën frënge.

Përkthyesit kanë bërë 836:30 orë përkthime të aty për atyshme në takime të rregullta, në seanca shqyrtuese dhe administrative, punëtori dhe konferenca të ndryshme, si dhe në intervista të kandidatëve për pozitat e shpallura nga GJKK-ja.

Në bashkërenditje me DRLSA-në, DPP-ja ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për takimet e gjyqtarëve dhe për seancat shqyrtuese e administrative.

DPP-ja ka bërë procedimin e lëndëve në gjuhën shqipe, gjuhën serbe dhe gjuhën angleze. Njëkohësisht, ka kontribuar në publikimin e vendimeve në gjuhën shqipe, serbe, angleze dhe frënge.

DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE

DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti i aprovuar për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për vitin 2023 ka qenë **2,179,861.00€**, dhe sipas strukturës përkatësisht kategorive ekonomike, pasqyrohen në paraqitjen tabelore.

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Subvencione dhe transfere	Granti i Këshillit të Evropës	Gjithsej
1,395,781.00€	518,000.00€	4,000.00€	110,000.00€	80,080.00€	72,000.00	2,179,861.00€

Buxheti i aprovuar 2023, alokimi dhe realizimi për periudhën janar – dhjetor

Në bazë të shkresës DBF-776 të datës 05 korrik 2023, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka kërkuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që të bëhet transferi/rialokimi i mjeteve nga nënprogrami i Gjykatës me kod 238, kategoria e shpenzimeve kapitale, nga projekti “Pajisje për IT” me kod 11132, të cilat janë transferuar në të njëjtin nënprogram por në kodin kapital 11135 “Softwer” në shumën prej 15,000.00€ .

Në bazë të shkresës SP/1082 të datës 27/10/2023 “Përmbyllja e vitit fiskal 2023”, kemi paraqitur kursimet në kategorinë e Pagave dhe mëditjeve dhe në kategorinë e Investimeve kapitale.

Bazuar në vendimin e Qeveris Nr. 16/174 të datës 22.11.2023, është bërë transferi/rialokimi i mjeteve nga projekti kapital ”Veturat” 11136 në shumën prej 40,000 euro dhe projekti Kapital “Pajisje të IT” 11132 në shumën prej 8,662.00 euro si shumë totale prej 48,662 euro tek kodi ekonomik 130 Mallrat dhe shërbimet.

Po ashtu, Gjykata Kushtetuese ka paraqitur kërkesën për mjete shtesë tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve (130) bazuar në Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2023 bazuar në Ligjin Nr. 08/L-193 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe me Ligjin Nr. 08/L-235, nenin 15, paragrafin 5 të ligjit, organizatave buxhetore iu mundëson që në tre mujorin e fundit të kërkojnë mjete shtesë, ku me vendimin e Qeverisë për kursime dhe ndarje nr. 04-179 të datës 21.12.2023 është aprovuar dhe ekzekutuar shuma prej 32,000 euro.

Në bazë vendimit të Qeverisë nr. 69/2023 të datës 27.12.2023, aprovohet transferi i mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë së shpenzimeve “Paga dhe mëditje”, duke i siguruar ato nga Organizatat Buxhetore ku ka tepriçë të mjeteve buxhetore përbrenda kategorisë së shpenzimeve “Paga dhe mëditje”.

Në mbështetje të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti i aprovuar për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për vitin 2023 me të gjitha këto ndryshime është paraqitur në tabelën si në vijim:

	Buxheti i aprovuar 2023 (A) €	Alokimet janar-dhjetor (B) €	Realizimet janar-dhjetor (C) €	% (C/A) €	% (C/B) €
Paga dhe mëditje	1,223,457.22	1,223,457.22	1,223,457.22	100	100
Mallra dhe shërbime	598,662.00	598,662.00	595,712.34	99.51	99.51
Shpenzime komunale	4,000.00	4,000.00	3,977.04	99.43	99.43
Subvencione dhe transfere	80,080.00	80,080.00	79,531.92	99.32	99.32
Investime kapitale	61,338.00	61,338.00	56,544.40	92.18	92.18
Granti i Këshillit të Evropës	72,000.00	72,000.00	69,801.69	96.95	96.95
Gjithsej	2,039,537.22	2,039,537.22	2,029,024.61	99.48	99.48

Alokimet e mjeteve financiare nga buxheti i Republikës së Kosovës sipas rrjedhës së parasë për periudhën janar – dhjetor

Në buxhetin e përgjithshëm pjesëmarrja e alokimit për vitin 2023 ka qenë 2,039,537.22€ e shprehur në përqindje 100% .

	Janar-shtator €	Tetor €	Nëntor €	Dhjetor €	Gjithsej €	%
Paga dhe mëditje	917,726.37	99,943.28	101,823.49	103,964.08	1,223,457.22	100
Mallra dhe shërbime	386,113.26	55,924.51	68,469.77	88,154.46	598,662.00	100
Shpenzime komunale	3,100.00	300.00	300.00	300.00	4,000.00	100
Investime kapitale	37,337.50	8,662.00	(8,662.00)	24,000.50	61,338.00	100
Subvencione dhe transfere	60,061.00	6,673.00	0.00	13,346.00	80,080.00	100
Granti i Këshillit të Evropës	72,000.00	0.00	0.00	0.00	72,000.00	100
Gjithsej	1,476,338.13	171,446.35	161,931.26	229,765.04	2,039,537.22	100

Realizimi i buxhetit për periudhën janar – dhjetor

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit për vitin 2023 ka qenë 2,029,024.61€ e shprehur në përqindje 99.48%.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim¹:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Subvencione dhe transfere	Granti i Këshillit të Evropës	Gjithsej
1,223,457.22€	598,662.00€	4,000.00€	61,338.00€	80,080.00€	72,000.00	2,039,537.22€

¹ Në realizimin e buxhetit nuk është përfshirë avansi për para të gatshme në shumë prej 1,000.00 €, pasi që nuk konsiderohet si shpenzim, realizim deri te rimbushja ose barazimi i avansit.

	Alokimet janar – dhjetor (A) €	Realizimi janar – dhjetor (B) €	Mbetja e mjeteve (C) €	% (B/A) €
Paga dhe mëditje	1,223,457.22	1,223,457.22	0.00	100
Mallra dhe shërbime	598,662.00	595,712.34	2,949.66	99.51
Shpenzime komunale	4,000.00	3,977.04	22.96	99.43
Subvencione dhe transfere	80,080.00	79,531.92	548.08	99.32
Investime kapitale	61,338.00	56,544.40	4,793.60	92.18
Granti i Këshillit të Evropës	72,000.00	69,801.69	2,198.31	96.95
Gjithsej	2,039,537.22	2,029,024.61	10,512.61	99.48

Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje

Realizimi i pagave dhe mëditjeve sipas muajve:

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Realizimi	Mbetja
Janar	61	104,517.46	104,517.46	0.00
Shkurt	61	101,082.75	101,082.75	0.00
Mars	61	101,847.63	101,847.63	0.00
Prill	63	101,808.16	101,808.16	0.00
Maj	63	104,015.20	104,015.20	0.00
Qershor	63	103,489.85	103,489.85	0.00
Korrik	63	98,547.67	98,547.67	0.00
Gusht	63	101,959.29	101,959.29	0.00
Shtator	63	100,458.36	100,458.36	0.00
Tetor	63	99,943.28	99,943.28	0.00
Nëntor	63	101,823.49	101,823.49	0.00
Dhjetor	63	103,964.08	103,964.08	0.00
Gjithsej		1,223,457.22	1,223,457.22	0.00

Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime

Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2023 të ndara sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	41,630.32	41,630.32	41,630.32	0.00
Shkurt	33,579.76	33,579.76	33,579.76	0.00
Mars	32,154.62	32,154.62	32,154.62	0.00
Prill	45,577.29	45,577.29	45,577.29	0.00
Maj	77,286.58	77,286.58	77,286.58	0.00
Qershor	45,181.49	45,181.49	45,181.49	0.00
Korrik	38,538.05	38,538.05	38,538.05	0.00
Gusht	22,208.66	22,208.66	22,208.66	0.00
Shtator	47,006.83	47,006.83	47,006.83	0.00
Tetor	55,924.51	55,924.51	55,924.51	0.00

Nëntor	68,469.89	68,469.89	68,469.77	0.12
Dhjetor	91,104.00	91,104.00	88,154.46	2,949.54
Gjithsej	598,662.00	598,662.00	595,712.34	2,949.66

Buxheti i ndarë për investime kapitale sipas kodeve të projekteve

Projektet	Kodet e projekteve	Buxheti i aprovuar €	Realizimi €	Mbetja €
Pajisje të TI-së	11132	16,338.00	12,294.40	4,043.60
Softuer	11135	45,000.00	44,250.00	750.00
Automjete	11136	0.00	0.00	0.00
Gjithsej:		61,338.00	56,544.40	4,793.60

Realizimi i buxhetit për shpenzime komunale

Realizimi i buxhetit në kategorinë e shpenzimeve komunale për vitin 2023 të ndara sipas muajve:²

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	350.00	350.00	226.82	123.18
Shkurt	350.00	350.00	225.97	124.03
Mars	350.00	350.00	235.30	114.70
Prill	350.00	350.00	225.47	124.53
Maj	350.00	350.00	245.57	104.43
Qershor	350.00	350.00	237.50	112.50
Korrik	350.00	350.00	259.00	91.00
Gusht	350.00	350.00	236.32	113.68
Shtator	300.00	300.00	235.23	64.77
Tetor	300.00	300.00	0.00	300.00
Nëntor	300.00	300.00	501.54	(201.54)
Dhjetor	300.00	300.00	1,348.32	(1,048.32)
Gjithsej	4,000.00	4,000.00	3,977.04	22.96

Realizimi i buxhetit për subvencione dhe transfere

Realizimi i buxhetit në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për vitin 2023 të ndara sipas muajve:

² Shpenzimet e komunaleve nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës janë bërë në kodin e telefonisë fikse si dhe në ngrohje qendrore, ndërsa shpenzimet e rrymës dhe mbeturinave mbulohen nga Ministria e Administratës Publike.

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	6,677.00	6,677.00	4,321.32	2,355.68
Shkurt	6,673.00	6,673.00	6,638.76	34.24
Mars	6,673.00	6,673.00	6,637.76	34.24
Prill	6,673.00	6,673.00	8,956.20	(2,283.20)
Maj	6,673.00	6,673.00	6,638.76	34.24
Qershor	6,673.00	6,673.00	6,638.76	34.24
Korrik	6,673.00	6,673.00	6,616.56	56.44
Gusht	6,673.00	6,673.00	6,616.56	56.44
Shtator	6,673.00	6,673.00	6,616.56	56.44
Tetor	6,673.00	6,673.00	6,616.56	56.44
Nëntor	6,673.00	6,673.00	0.00	0.00
Dhjetor	6,673.00	6,673.00	13,233.12	112.88
Gjithsej	80,080.00	80,080.00	79,531.92	548.08

Realizimi i buxhetit nga Granti i Këshillit të Evropës

Realizimi i buxhetit nga Granti i Këshillit të Evropës për vitin 2023 të ndara sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	0.00	0.00	0.00	0.00
Shkurt	0.00	0.00	0.00	0.00
Mars	72,000.00	72,000.00	0.00	0.00
Prill	0.00	0.00	0.00	0.00
Maj	0.00	0.00	0.00	0.00
Qershor	0.00	0.00	0.00	0.00
Korrik	0.00	0.00	0.00	0.00
Gusht	0.00	0.00	0.00	0.00
Shtator	0.00	0.00	40,801.00	0.00
Tetor	0.00	0.00	0.00	0.00
Nëntor	0.00	0.00	0.00	0.00
Dhjetor	0.00	0.00	29,000.69	0.00
Gjithsej	72,000.00	72,000.00	69,801.69	2,198.31

NJËSIA E PROKURIMIT

NJËSIA E PROKURIMIT

Në mbështetje të planit të prokurimit për vitin 2023, Njësia e Prokurimit ka iniciuar dhe zhvilluar gjithsej tridhjetë e tri (33) aktivitete të prokurimit dhe janë nënshkruar 31 kontrata.

Bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, aktivitetet e prokurimit i kemi klasifikuar sipas tipit (llojit), vlerës dhe procedurës, në vijim paraqiten në detaje:

- 1) Procedurë me vlerë minimale (deri nën njëmijë euro);**
- 2) Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël);**
- 3) Procedurë e hapur (vlerë e mesme);**
- 4) Procedurë e hapur kornizë – (vlerë e mesme);**
- 5) Procedurë e hapur kornizë (vlerë e madhe);**
- 6) Procedurë e negociuar pa publikimin e Njoftimit për kontratë.**

1) Procedurë me vlerë minimale

Gjatë vitit 2023 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 9 (nëntë) aktivitete me vlerë minimale dhe janë nënshkruar 9 (nëntë) kontrata, siç paraqiten në vijim:

1. Furnizim me Barcode Printer dhe Barcode Scanner;
2. Ndërrimi dhe montimi i gomave, balancimi dhe hotelimi (ruajtja) e gomave
3. Shërbime të transportit me autobus nga Prishtina në Selanik të Greqisë dhe anasjelltas;
4. Ri-tenderim (kuotim) - Furnizimi me licencë një vjeçare për Platformën Online Zoom Communication;
5. Ri-kuotim; Veshja me pëlhurë e karrigeve;
6. Ri-tenderim, Lot 4, Furnizimi me libra te autorëve;
7. Shërbimet e transportit të përkohshëm për vitin gjyqësor;
8. Hartimi i ekspertizës për defektin e shkaktuar në veturën Shkoda Super B;
9. Furnizimi për fund vit – (Lot I – punim dore).

2) Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël)

Gjatë vitit 2023, janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsejtë tetë (8) aktivitete të kuotimit të çmimeve dhe janë nënshkruar tetë (8) kontrata, siç paraqiten në vijim:

1. Furnizim me material shpenzues zyrtar;
2. Ofrimi i shërbimeve të zërimit dhe incizimeve për konferenca;
3. Furnizimi me pajisje të Teknologjisë Informative “Touch-pad Smartboard dhe kamerë për konferenca”;
4. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative;
5. Ri-tender, Furnizimi me licenca Trados Studio 2022;
6. Ri-tenderim; Loti 1, Shërbime dhe furnizimi me punime dore nga argjendi;
7. Loti 2. Shërbime dhe furnizime me artikuj protokollar - Pjata dekorative;
8. Furnizimi me pajisje të WIFI – Wireless.

3) Procedurë e hapur (vlerë e mesme)

Gjatë vitit 2023, janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsejtë 2 (dy) aktivitete - Procedurë e hapur dhe janë nënshkruar 2 kontrata, siç paraqiten në vijim:

1. Furnizim me pajisje te IT-së;

2. Avancimi i CDMS dhe uebfaqes.

4) Procedurë e hapur kornizë – vlerë e mesme

Gjatë vitit 2023, janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsejtë 7 (shtatë) aktivitete - Procedurë e hapur kornizë, vlerë e mesme dhe janë nënshkruar 7 kontrata, siç paraqiten në vijim:

- 1) Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe logjistikes;
- 2) Sigurimi i veturave zyrtare TPL, TPL Plus dhe Full Kasko-EU;
- 3) Lot 1: Shërbimet e xhirimit;
- 4) Lot 2: Shërbimet e fotografimit;
- 5) Shërbimet e transportit ajror;
- 6) Mirëmbajtja dhe servisimi i Peugeot 308 dhe Mercedes C200;
- 7) Mirëmbajtja e serverëve.

5) Procedurë e hapur kornizë (vlerë e madhe)

Gjatë vitit 2023 është nënshkruar kontratë në dy Lot për një shërbim vlerë e madhe në vijim paraqesim:

- 1) Lot I - “Shërbime të përkthimit me shkrim, lektura dhe harmonizimi i teksteve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, gjuhën serbe, në gjuhë të tjera sipas nevojës dhe anasjelltas”.
- 2) Lot II - “Përkthimi i atypëratyshëm (simultan) i seancave dhe takimeve zyrtare”.

6) Procedurë e negociuar pa publikimin e Njoftimit për kontratë

Gjatë vitit 2023, janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 3 (tri) aktivitete - Procedurë e negociuar vlerë e mesme dhe janë nënshkruar 3 kontrata, siç paraqiten në vijim:

- 1) Lot I – “ Shërbime të përkthimit me shkrim, lektura dhe harmonizimi i teksteve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, në gjuhën serbe, në gjuhë të tjera sipas nevojës dhe anasjelltas 3 mujore.
- 2) Mirëmbajtja dhe Pastrimi i objektit të Gjykatës Kushtetuese 3 mujore
- 3) Furnizimi për fundvit; Ri-tenderim (Lot II - kuponë furnizimi për stafin e Gjykatës Kushtetuese) të menjëhershme.

Gjatë vitit 2023, janë anuluar 9 procedura, për shkak se asnjë ofertë nuk ishte e përgjegjshme, për 7 prej tyre me Ri-tenderim janë nënshkruar kontratat, ndërsa për dy (2) prej tyre edhe pas Ri-tenderimit janë anuluar dhe kanë mbetur për t’u zhvilluar procedurat e prokurimit në vitin 2024, siç paraqiten në vijim:

- 1) Mirëmbajtja e pjesëve të TI-së është anuluar më 22.11.2023;
- 2) Avancimi i sistemit të telefonisë VIOP dhe Time Attendance është anuluar më 09.11.2023.

Shuma e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2023, duke përfshirë të gjitha taksat, ishte **859,483.40 €**

**NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
MULTIMEDIAVE**

NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIAVE

Njësia e Teknologjisë së Informacionit, Komunikimit dhe Multitmedia, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesjen profesionale në infrastrukturën e përgjithshme të teknologjisë informative në Gjykatën Kushtetuese.

Gjatë vitit 2023, njësia TIK dhe Multimedia ka realizuar projekte të rëndësishme, duke krijuar sisteme të qëndrueshme dhe profesionale, me pajisje të reja të avancuara dhe të sigurta për qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe arritjes së sigurisë në përputhje me planin e punës dhe planin strategjik të Gjykatës Kushtetuese.

Projektet e realizuara

- Projekti për avancimin e sistemit CDMS dhe Ueb faqes, që është financuar nga Këshilli i Evropës, ky projekt është realizuar sipas dinamikës dhe planit të paraparë duke zbatuar të gjitha pikat e parapare në plan, janë mbajtur takimet e rregullta me grupin punues, ku gjatë kësaj periudhe janë instalua dhe testuar disa versione me ndryshimet e fundit sipas kërkesave nga njësit përkatëse që duhet të zhvillohen për avancimin e sistemeve dhe ueb faqes;
- Migrimi i të dhënave dhe përfundimi i versionit final të sistemit për burimet njerëzore dhe të logjistikës HRMIS, përgatitja dhe instalimi i databazës në SQL server dhe IIS web-serverit për funksionimin e aplikacionit HRMIS për të gjithë personelin brenda rrjetës së Gjykatës;
- Montimi dhe konfigurimi i sistemit të ri të rrjetës Wi-Fi duke mbuluar të gjithë hapësirat e Gjykatës, gjithsej janë montuar 10 shpërndarës të rrjetës pa tela Wi-Fi, kjo infrastrukturë e rrjetës është konfiguruar me qasje të avancuar dhe të sigurt duke rritur sigurinë e brendshme gjatë qasjes për përdorime të brendshme nga stafi dhe vizitoret;
- Montimi dhe konfigurimi i 6 switchave (shpërndarësit e rrjetës) Cisco në nyjat kryesore të rrjetave dhe zëvendësimi i pajisjeve të vjetra sipas planit strategjik, switchat janë konfiguruar dhe montuar për të rritur shpejtësinë dhe mënjanimin e ndërprerjeve në komunikimit brenda pajisjeve në rrjetën e Gjykatës;
- Janë montuar dhe konfiguruar dy TV smartboard 65 inch në gjykatore dhe në sallën e trajnimeve së bashku me sistemin e kamerës për konferenca, për të mundësuar mbajtjen e seancave online, konferencave dhe trajnimeve
- Hapja dhe publikimi i faqes zyrtare në platformën sociale Facebook dhe konfigurimi i parametrevë të faqes sipas politikave të brendshme të Gjykatës;
- Blerja e pajisjeve, softuerëve dhe kontraktimi i shërbimeve të TIK-ut, janë iniciuar dhe përfunduar proceduara për blerjen e pajisjeve të Teknologjisë Informative, softuer dhe shërbime tjera profesionale, ku të gjitha projektet janë realizuar sipas planit të parapare për vitin 2023, të gjitha shërbimet e IT-së, softuerët dhe pajisjet janë montuar dhe konfiguruar sipas politikave të brendshme të Gjykatës;
- Blerja dhe instalimi i licencave për softuerin Trados Studio 2022, softueri është konfiguruar brenda rrjetës së brendshme të Gjykatës dhe është në përdorim të plotë nga përkthyesit e Gjykatës;

- Konfigurimi dhe aprovimi i politikave të brendshme të sigurisë dhe aplikimi për të gjithë përdoruesit në domenin e Gjykatës, në mënyrë të vazhdueshme janë monitoruar dhe kontrolluar heshtjet e tentim sulmeve, duke ofrua këshilla për të gjithë stafin për kujdesin ndaj mashtrimeve nëpërmjet e-mailave adresave mashtrues;
- Konfigurimi dhe administrimi i pajisjeve të zerimit dhe të përkthimit në sallën e gjykimit për mbajtjen e seancave të rregullta sipas orarit që janë kërkuar;
- Konfigurimi dhe administrimi i seancave shqyrtuese online, takimeve, konferencave ndërkombëtare dhe trajnimeve të ndryshme nëpërmjet platformës Zoom;
- Dizajnimi dhe publikimi i Buletinit periodik të praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetues për periudhat tremujore, gjithsej janë publikuar 4 buletine periodike.

Aktivitetet e ndërmarra

- Administrimi dhe mirëmbajtja e serverëve dhe infrastrukturës teknologjike, duke vazhduar angazhimin e plotë nën përkujdesjen e stafit profesional të Njesisë së TIK-ut, gjatë kësaj periudhe janë administruar dhe mirëmbajtur të gjithë serverët në gjendje funksionale, duke u kujdesur në mënyrë periodike për monitorimin e gjendjes fizike, menaxhimin dhe kontrollin e sigurisë, kontrollimin e llogave, monitorimin e temperaturës në dhomën e serverëve dhe furnizimin me rrymë dhe UPS për infrastrukturën teknologjike dhe pajisjeve përcjellëse. Gjatë kësaj periudhe janë zëvendësuar disa pjesë të dëmtuara në dhomën e serverëve dhe këto intervenime dhe konfigurime janë kryer me sukses, duke kthyer sistemin në funksion të plotë. Për të gjithë serverët fizik dhe ata virtual janë krijuar dhe administruar kopjet rezervë në rastet e sigurisë.
- Intervenimi dhe kontrollimi i rrjetës brenda Gjykatës dhe përditësimin e versioneve të reja (update) të sistemeve operative dhe pakove të Office, për të gjitha pajisjet duke i aprovuar dhe instaluar me kujdes nga Administratori i Sistemit;
- Krijimi i kopjeve (back-up) të rregullt për data-bazën e CDMS-it, përkujdesja dhe eliminimi i gabimeve, si dhe siguri në ruajtjen e të dhënave në dy kopjet e serverëve;
- Përkujdesja dhe ofrimi i shërbimeve për mbarëvajtjen e sistemeve operative dhe pajisjeve të teknologjisë dhe komunikimit për të gjithë të punësuarit në Gjykatë, është intervenuar edhe përmes distancës në ofrimin e shërbimeve të IT-së për mbajtjen e seancave online.
- Menaxhimin dhe organizimin e detyrave teknike brenda Njesisë duke ofruar përkrahjen e nevojshme për funksionalizimin sa më të mirë të pajisjeve të Teknologjisë Informative dhe sistemeve brenda Gjykatës;
- Konfigurimi dhe instalimi i konzollës të Antivirusit në serverët e Gjykatës dhe aplikimi i përditësimeve të reja të Microsoft-it për të gjithë kompjuterët;
- Pjesëmarrja në komisionet me grupet punuese për ndryshimet dhe përditësimet e akteve të brendshme ligjore.
- Gjatë vitit 2023 janë kërkuar për të iniciuar gjithsej 10 procese të prokurimit për blerjen e pajisjeve të ndryshme të IT-së, shërbime dhe mirëmbajtje, softuer dhe pjesë përcjellëse sipas planit të paraparë për këtë vit.

- Montimi, instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve të ri për Gjyqtarët dhe regjistrimi në domenin e GJKK-së, transferimit i të dhënave, duke i mirëmbajtur pajisjet e brendshme në ngritjen e sistemeve operative në Windows 10 dhe softuerët tjerë aplikativ.
- Gjatë vitit 2023 janë publikuar 208 vendime në ueb-faqe në gjuhët përkatëse dhe është bërë kategorizimi i tyre në bazë listës së filtrimit;

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Bazuar në planin vjetor për vitin 2023, NJAB ka planifikuar gjithsej katër (4) auditime dhe dy raporte për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.

Raportet e finalizuara nga NJAB gjatë vitit 2023 janë:

1. "Menaxhimi i kontratave në NJP",
2. "Menaxhimi logjistikës" në kuadër të DABNJ-së,
3. "Menaxhimi i Arkivës" në të DRLSA-së,
4. "Menaxhimi i shpenzimeve", dhe
5. "Menaxhimi i prokurimit".

Në fillim të gjashtëmuorit të I-të dhe në fillim të gjashtëmuorit të II-të janë monitoruar dhe janë përgatitur raporte për zbatimin e rekomandimeve.

Po ashtu, NJAB ka hartuar dhe ka dorëzuar brenda afatit të caktuar:

- **Planin Strategjik të AB-së për periudhën 2024-2026, dhe**
- **Planin Vjetor të AB-së për vitin 2024.**

Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të NJAB-së që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, rritjen e vlerës dhe raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim të shtimit të kontrollit që të ofrojë siguri tek menaxhmenti për funksionim efikas në departamentet përkatëse.

Në vazhdimësi janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Menaxhmenti ka vlerësuar punën e auditorëve dhe në rastin e parë të mundshëm është kujdesur për implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga auditori i brendshëm, ashtu edhe nga auditorët e përgjithshëm, e kjo ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së aktiviteteve dhe performancës së institucionit.

1. Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm - organ i pavarur këshillëdhënës - në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, funksionon bazuar në:

- Udhëzimin Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik,
- Statutin e KAB-s;
- Praktikrat e mira, dhe
- Standardet ndërkombëtare të auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2023 ka mbajtur pesë (5) takime dhe siguron mbikëqyrje të planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM

Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI) në fushën e përgjegjësive të saj përfshinë: informimin dhe komunikimin me mediat/publikun; monitorimin e mediave; publikimin në ueb-faqen e Gjykatës dhe në faqet e Gjykatës në rrjetet sociale të njoftimeve përkitazi me vizitat/aktivitetet dhe seancat/vendimet; përgatitjen dhe publikimin e Buletinit Informativ të Gjykatës; përgatitjen dhe publikimin e Librit të Gjykatës, fletushkave/broshurave dhe materialeve tjera informative; komunikimin me palët/qytetarët; protokollin; kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës dhe mbrojtjen e të dhënave personale; si dhe bashkëpunimin me Komisionin e Venecias.

Gjatë vitit 2023, në Zyrën për Komunikim dhe Informim (ZKI), janë kryer këto aktivitete:

I. Monitorimi i mediave:

- Janë përpiluar 145 raporte ditore të mediave;
- Janë përpiluar 49 raporte javore të mediave;
- Është bërë arkivimi fizik dhe elektronik i raporteve të mediave të shtypura (66 artikuj) dhe të mediave elektronike (448 artikuj) përkitazi me punën e Gjykatës.

II. Komunikimi me mediat/publikun:

- Është vendosur në receptionin e Gjykatës, “Këndi i ankesave” për qytetarët;
- Janë hapur faqet e Gjykatës në rrjetet sociale “X” dhe “Facebook”;
- Janë dërguar përgjigjet në 184 pyetje të parashtruara nga mediat e shkruara dhe ato elektronike, si dhe në 498 pyetje/kërkesa të parashtruara nga qytetarët dhe institucionet;
- Janë publikuar 34 njoftime në ueb-faqen zyrtare dhe 23 njoftime në faqet e Gjykatës në rrjetet sociale “Facebook” dhe “X” përkitazi me vizitat dhe aktivitetet e realizuara;
- Janë publikuar 39 njoftime me informata përmbledhëse përkitazi me vendimmarrjen e Gjykatës;
- Janë publikuar 12 njoftime me informata statistikore përkitazi me seancat dhe vendimet e publikuara të Gjykatës.

III. Publikimi i fletushkave/broshurave dhe i materialeve të tjera informative:

- Është publikuar Raporti Vjetor i mediave për vitin 2022;
- Është publikuar numri i 15-të dhe i 16-të i Buletinit Informativ të Gjykatës;
- Është publikuar Buletini i Praktikës Gjyqësore për vitin 2022;
- Janë publikuar katër Buletine tremujore të Praktikës Gjyqësore;
- Është përgatitur dhe publikuar versioni i ri i Raportit Vjetor të punës për vitin 2022;
- Është vendosur në receptionin e Gjykatës materiali informativ përkitazi me procedurën e parashtrimit të kërkesave dhe orientimin numerik në zyrat e Gjykatës;

- Është përgatitur dhe publikuar video-animacioni: “Si i merr vendimet Gjykata Kushtetuese”;
- Është përgatitur dhe publikuar video-prezantimi me rastin e 14 vjetorit të themelimit të Gjykatës.

IV. Aktivitetet protokollare:

- Janë kryer detyrat protokollare përkitazi me 40 vizita zyrtare në Gjykatë, 17 vizita zyrtare jashtë vendit, 11 punëtori/konferenca të organizuara në vend, 6 punëtori/konferenca të organizuara jashtë vendit dhe 2 punëtori/konferenca të organizuara nëpërmjet video-konferencës;
- Janë përgatitur 163 letër-këmbime me përfaqësues institucional vendor e ndërkombëtar.

V. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:

- Gjatë vitit 2023, janë pranuar gjithsej 25 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës. Nga ky numër, 24 kërkesa për qasje janë aprovuar tërësisht, ndërkaq 1 kërkesë për qasje është lejuar pjesërisht.
- Janë përgatitur 4 raporte tremujore përkitazi me kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës.
- Është dorëzuar në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, Raporti Vjetor për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës gjatë vitit 2023.

VI. Komunikimi me palët/qytetarët:

Gjatë vitit 2023, në recepsionin e Gjykatës janë regjistruar dhe proceduar:

- 690 qytetarë;
- 480 përfaqësues institucionesh.

VII. Bashkëpunimi me Komisionin e Venecias:

- Janë dërguar përgjigjet e Gjykatës në 66 pyetje të parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga 13 gjykata kushtetuese dhe supreme të shteteve anëtare (me gjithsej 19 kërkesa);
- Janë dorëzuar 3 raporte katërmujore, së bashku me vendimet më të rëndësishme të Gjykatës për publikim në Buletinet e Komisionit të

AKTIVITETET TJERA TË GJYKATËS KUSHTETUESE

AKTIVITETET TJERA TË GJYKATËS KUSHTETUESE

I. Udhëtimet zyrtare

30 janar - 3 shkurt 2023

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka-Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Lisbonë të Portugalisë nga 30 janar deri më 3 shkurt 2023. Vizita u realizua me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë në kuadër të projektit “Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në zbatimin dhe përhapjen e standardeve evropiane të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

Gjatë qëndrimit treditor në Portugali, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese zhvilloi takime me Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën Supreme të Drejtësisë, Gjykatën Supreme Administrative dhe përfaqësues të Parlamentit të Republikës së Portugalisë.

Në Gjykatën Kushtetuese të Portugalisë, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u mirëprit nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë, z. João Pedro Barrosa Caupers dhe gjyqtarët tjerë, të cilët së bashku diskutuan për juridiksionet e të dy gjykatave, karakteristikat e sistemit portugez në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me fokus të veçantë në kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore në kohë emergjencash dhe jurisprudencën e të dy gjykatave në lidhje me pandeminë Covid-19.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës gjithashtu vizitoi Gjykatën Supreme të Drejtësisë të Portugalisë, ku u mirëprit nga Kryetari i saj, z. Henrique Luís de Brito de Araújo dhe gjyqtarët tjerë, me të cilët diskutuan bashkërisht për funksionet, kompetencat dhe përbërjen e kësaj gjykate. Ndërsa, gjatë vizitës në Gjykatën Supreme Administrative, delegacioni i Kosovës u mirëprit nga Kryetarja e kësaj gjykate, znj. Dulce Manuel da Conceição Neto dhe gjyqtarët tjerë, ku temë e diskutimit të përbashkët ishin po ashtu juridiksioni, përbërja dhe puna e këtij institucioni. Gjatë vizitës në të tri gjykatat respektive, delegacionet u dakorduan edhe për mekanizmat e thellimit të bashkëpunimit në të ardhmen.

Delegacioni i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u takua edhe me deputetë të Parlamentit të Portugalisë, gjatë të cilit takim diskutuan për drejtësinë kushtetuese dhe rëndësinë e saj në avancimin e parimit të sundimit të ligjit, si dhe për rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë të dyja vendeve.

27 - 28 mars 2023

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka-Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE), me seli në Luksemburg më 27-28 mars 2023.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese fillimisht u prit në takim nga Zëvendëskryetari i GJDBE-së, z. Lars Bay Larsen dhe Avokati i Parë i Përgjithshëm, z. Maciej Szpunar, me të cilët, Kryetarja Caka-Nimani dhe gjyqtarët e tjerë kushtetues, bashkëbiseduan përkitazi me funksionin dhe kompetencat që ka kjo gjykatë në kuadër të strukturave të drejtësisë të Bashkimit Evropian. Kryetarja i njoftoi rreth juridiksionit, kompetencave dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, përfshirë rolin dhe rëndësinë e praktikës së GJDBE-së në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese.

Takimi i përbashkët vazhdoi me pjesëmarrjen e gjyqtarëve të të dy gjykatave në tryezën e rumbullakët me temë “Karta e të Drejtave Themelore të BE-së”, ku në mesin e folësve kryesor

ishite edhe Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani. Gjatë kësaj tryeze, u diskutua gjithashtu ndërveprimi në mes të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe ndërveprimi në mes të GJDBE-së dhe GJEDNJ-së për sa i përket kësaj fushe të juridiksionit.

Kryetarja Caka-Nimani u prit në takim edhe nga Kryetari i GJDBE-së, z. Koen Lenaerts, me të cilin diskutuan rreth mundësive të bashkëpunimit në mes të dy gjykatave. Gjithashtu, delegacioni i Gjykatës mori pjesë në një seancë publike të Dhomës së Madhe të GJDBE-së.

Vizita e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian u përmbyllë me diskutime të përbashkëta me Kryetarë Dhomash të Gjykatës së Drejtësisë, gjyqtarë të kësaj gjykate dhe të Gjykatës së Përgjithshme.

10 maj 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Tiranë më 10 maj 2023.

Vizita e Kryetares Caka-Nimani në kryeqytetin shqiptar u organizua nga Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, me ftesën për të marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare të organizuar në shënim të 110-vjetorit të themelimit të kësaj gjykate me temën “*Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti kombëtar tek vlerat universale*”.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, Kryetarja Caka-Nimani u prit në takime të veçanta nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, z. Sokol Sadushi dhe nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Holta Zaçaj.

Temë e diskutimit të përbashkët në të dyja takimet ishte thellimi i mëtutjeshëm i marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit me gjykatat respektive dhe përpjekjet e përbashkëta për forcimin e sundimit të ligjit në të dyja vendet.

10 - 13 korrik 2023

Gjyqtari Nexhmi Rexhepi qëndroi për vizitë pune disaditëshe në Këshillin Shtetëror të Francës (Conseil d’Etat), me seli në Paris, Francë.

20 - 21 korrik 2023

Gjyqtaret Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Remzije Istrefi-Peci morën pjesë në Kongresin e 20-të Botëror të së Drejtës, që u mbajt në Nju Jork të SHBA-ve.

27 tetor 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani dhe kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Bullgarisë, znj. Pavlina Palova, si dhe kryetarët e Gjykatave Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Turqisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, nënshkruan në Sofje të Bullgarisë, Memorandumin e Mirëkuptimit, përmes të cilit u themelua Forumi Ballkanik i Gjykatave Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës bëhet për herë të parë anëtare themeluese dhe me të drejta të barabarta e një forumi profesional ndërkombëtar të drejtësisë kushtetuese. Në cilësinë e Anëtarëve Vëzhgues, pjesë e Forumit Ballkanik të Gjykatave Kushtetuese, që u themelua edhe me përkrahjen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, janë edhe Gjykata Kushtetuese e Bosnjë dhe Hercegovinës, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, Këshilli Shtetëror i Greqisë dhe Gjykata Kushtetuese e Rumanisë.

11 nëntor 2023

Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Bajram Ljatifi, udhëtoi në një vizitë zyrtare në Sarajevë, me ftesë të organizatave joqeveritare ndërkombëtare “Civil Rights Defender” me seli në Stokholm dhe “AIRE Centre” me seli në Londër.

Zëvendëskryetari Ljatifi është ftuar për të marrë pjesë në Forumin e 10-të Rajonal të Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore, më 10-11 nëntor 2023, në kryeqytetin e Bosnjë dhe Hercegovinës, në temën “*Balancimi i mbrojtjes së të dhënave me drejtësinë transparente: Korniza ligjore evropiane*”.

Forum i Rajonal i Shtetit të së Drejtës është një ndër ngjarjet me rëndësi të vitit për përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor, avokatët e të drejtave të njeriut, komunitetin juridik dhe organizatat joqeveritare në Ballkanin Perëndimor, që për qëllim primar ka promovimin dhe zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nxitjen e bashkëpunimit rajonal për forcimin e sundimit të ligjit, si dhe të ofrojë ndihmë në procesin e integritetit të shteteve të rajonit në Bashkimin Evropian.

27 nëntor 2023

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka-Nimani, zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë, me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në ceremoninë e miratimit të 25 vjetorit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në konferencën ndërkombëtare të organizuar me rastin e përvjetorit jubilar.

Kryetarja Caka-Nimani ishte njëra ndër folëset kryesore në konferencën ndërkombëtare, në të cilën morën pjesë kryetarë e gjyqtarë të gjykatave kushtetuese evropiane, si dhe përfaqësuesit më të lartë institucional të shtetit shqiptar.

II. Vizitat zyrtare në Gjykatën Kushtetuese/Aktivitete të tjera

13 janar 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani dhe shefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, z. Frank Power, nënshkruan në një ceremoni të përbashkët marrëveshjen e grantit të Këshillit të Evropës për Gjykatën Kushtetuese.

Objekt i marrëveshjes për grantin është mbështetja dhe financimi i disa projekteve të destinuara për avancimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të përgjithshme të shërbimeve të teknologjisë së informacionit në Gjykatën Kushtetuese.

Përmes fondeve të siguruar nga Këshilli i Evropës, marrëveshja e arritur do të mundësojë blerjen e sistemeve të avancuara harduerike dhe softuerike që do të kontribuojnë në lehtësimin e procesit të menaxhimit të lëndëve, përmirësimin e sistemeve për menaxhimin e bazës së të dhënave dhe avancimin e funksionalitetit të uebfaqes së Gjykatës Kushtetuese.

Marrëveshja e nënshkruar është pjesë e projektit të Këshillit të Evropës “*Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe përhapjen e standardeve evropiane të të drejtave të njeriut*”.

13 janar 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani dhe Dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prof. Dr. Avni Puka, nënshkruan në një ceremoni të përbashkët Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Fakultetit Juridik të UP-së.

Objekt i marrëveshjes së nënshkruar, ndër të tjera, janë zhvillimi i veprimtarive të përbashkëta me qëllim thellimin dhe shkëmbimin e njohurive në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut, të gjyqësisë kushtetuese dhe sundimit të ligjit, si dhe pjesëmarrja e ndërsjellë në seminare dhe konferenca profesionale.

Pjesë e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit janë edhe ligjëratat e kohëpaskohshme të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese para studentëve të Fakultetit Juridik të UP-së, qasja e studentëve të drejtësisë në nivelin master dhe të doktoratës në Bibliotekën e Gjykatës për qëllime akademike dhe kërkimore, si dhe angazhimi i studentëve të Fakultetit Juridik si praktikantë në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese dhe Fakulteti Juridik mbesin të përkushtuar, bashkërisht dhe secili brenda kompetencave të veta, do të mbështesin avancimin e vazhdueshëm të gjeneratave të reja të juristëve.

19 janar 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani dhe drejtori i Projektit për Drejtësi të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë, Artan Hadri, nënshkruan në një ceremoni të përbashkët Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe USAID-it.

Objekt i memorandumit të nënshkruar, ndër të tjera, janë përmirësimi i kapaciteteve institucionale të Gjykatës Kushtetuese për ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët në kërkim të mbrojtjes së të drejtave të tyre themelore të garantuara me Kushtetutë dhe sigurimi i qasjes më të lehtë të qytetarëve në objektin e Gjykatës.

Aktivitetet e planifikuara në kuadër të memorandumit gjithashtu përfshijnë ndihmën e USAID-it në organizimin e tryezave të rrumbullakëta ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe mediave.

Memorandumi i Mirëkuptimit shënon vazhdimësinë e përkrahjes së USAID-it për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, si një ndër donatorët dhe mbështetësit kryesor të projekteve të ndryshme të realizuara ndër vite për avancimin e kapaciteteve profesionale dhe infrastrukture të Gjykatës

19 - 22 janar 2023

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës në Prishtinë “Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese”, mbajtën Punëtorinë Orientuese për Gjyqtarin e ri të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht z. Enver Peci, më 19 - 22 janar 2023, në Budva, Mal të Zi.

26 janar 2023

Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Remzije Istrefi-Peci, dhe zv. Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, z. Veton Dula, pritën në takim të përbashkët një grup studentësh

ndërkombëtarë të Programit Evropian (EMA) për studime pasuniversitare në fushën e të drejtave të njeriut dhe demokratizim, nga kampuset universitare në Vjenë dhe Venedik.

Historiku i themelimit të Gjykatës Kushtetuese dhe i miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, roli dhe përgjegjësitë e Gjykatës, si dhe juridiksioni dhe palët e autorizuara për parashtrimin e kërkesave ishin vetëm disa ndër temat për të cilat gjyqtarja Istrefi-Peci diskutoi gjatë prezantimit të saj.

Gjyqtarja Istrefi-Peci në vazhdim i njoftoi studentët ndërkombëtarë edhe për zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe obligimin kushtetues për respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Pas prezantimit që zv. Sekretari i Përgjithshëm i bëri strukturës aktuale të Gjykatës dhe përbërjes së saj të parë me gjyqtarë dhe këshilltarë ndërkombëtarë, studentët shprehën interesimin e tyre që të informohen më për së afërmi përkitazi me natyrën e vendimeve që i nxjerr Gjykata Kushtetuese, arsyet më të shpeshta për shpalljen e kërkesave të parashtruara si të papranueshme dhe për kohëzgjatjen e shqyrtimit të rasteve.

13 shkurt 2023

Një grup prej 15 arsimtarësh të lëndës “Edukata Qytetare” në shkollat fillore të komunës së Fushë Kosovës, Shtimes, Vitisë, Prizrenit dhe Prishtinës vizituan Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në kuadër të programit të trajnimit “*Fuqizimi i të rinjve – Avancimi i sundimit të ligjit dhe edukimi mbi të drejtat e njeriut në shkollë*”, i mbështetur nga Misioni i EULEX-it në Kosovë dhe që zbatohet nga organizata joqeveritare Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR-KS).

Arsimtarët u pritën në takim nga gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhmi Rexhepi, i cili ndër të tjera, i njoftoi ata përkitazi me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe palët e autorizuara për parashtrimin e kërkesave, për përbërjen e gjyqtarëve kushtetues dhe procesin e zgjedhjes së tyre, si dhe për vendimmarrjen e Gjykatës dhe mekanizmat në dispozicion për monitorimin e zbatueshmërisë së tyre.

Ndër çështjet për të cilat arsimtarët shprehën interesimin e tyre që të informohen më në detaje për sa i përket punës dhe veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese, ishte edhe procedura e për zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, mandati i tyre si gjyqtarë dhe mënyra e votimit gjatë trajtimit të lëndëve.

16 shkurt 2023

Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës u mbajt punëtorja informuese me gjyqtarë dhe prokurorë të sapoemëruar, e organizuar në kuadër të programit të trajnimit fillestar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

Gjyqtarët dhe prokurorët e rinj u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka-Nimani, e cila gjatë prezantimit fillimisht diskutoi përkitazi me rolin dhe juridiksionin që ka Gjykata në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, për strukturën organizative dhe përbërjen e saj, si dhe palët e autorizuara për parashtrimin e kërkesave.

Kryetarja Caka-Nimani në vijim foli më në detaje për kriteret e pranueshmërisë dhe trajtimin e kërkesave të parashtruara, për raportet e Gjykatës Kushtetuese me gjykatat e niveleve të tjera në vend, si dhe për mundësitë që nëpërmjet mekanizmit të kontrollit incidental gjykatat e rregullta t’i drejtohen Gjykatës për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së një ligji, që mund të jetë kontestuar gjatë procedurës gjyqësore.

Gjatë bashkëbisedimit, gjyqtarët dhe prokurorët e rinj shprehën interesimin e tyre që të informohen më hollësisht lidhur me rastet kur Gjykata mund të rishikojë praktikën e saj gjyqësore, dallimin në mes të kontrollit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së akteve, si dhe për aspekte të ndryshme të procedurës së referimit të kërkesave përmes kontrollit incidental dhe kriteret mbizotëruese për të vendosur nëse kushtetutshmëria e një ligji duhet të referohet në Gjykatën Kushtetuese.

27 shkurt - 18 mars 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës në Prishtinë “*Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese*”, qëndroi për vizitë pune në GJEDNJ, nga 27 shkurt - 18 mars 2023, në Strasburg, Francë.

9 - 10 mars 2023

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese në zbatimin dhe përhapjen e standardeve evropiane për të drejtat e njeriut”, mbahet punëtorja e IV për Gjyqtarë dhe Këshilltarë Ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht mbi temën: “*Të drejtat e pronës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”, më 9 - 10 mars 2023, në Ohër, Maqedonia e Veriut.

15 - 17 mars 2023

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës mbajti punëtorinë mbi Planit e Veprimit dhe Regjistrin e Rrezikut 2023 të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese më 15 - 17 mars 2023, në Durrës, Shqipëri.

7 prill 2023

Në shënim të Ditës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të miratuar më 9 prill të vitit 2008, Gjykata Kushtetuese organizojë aktivitetin e radhës “Dita e Gjykatës së Hapur” më 7 prill 2023. Gjykatën e vizituan një grup qytetarësh, studentë të drejtësisë dhe përfaqësues të komunitetit juridik, të cilët përveç se u informuan përkitazi me historikun dhe me punën e deritanishme të Gjykatës, vizituan edhe Gjykatoren, Bibliotekën dhe zyrat në të cilat punojnë zyrtarët dhe gjyqtarët kushtetues.

19 maj 2023

Një grup studentësh të vitit të parë të Fakultetit Juridik në kuadër të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese, më 19 maj 2023. Studentët u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka -Nimani dhe gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Safet Hoxha.

Pasi që u shprehu mirëseardhjen, kryetarja Caka-Nimani i njoftoi juristët e ardhshëm me funksionin që ka Gjykata Kushtetuese në raport me pushtetet e tjera në vend dhe me rolin me rëndësi që ka luajtur ajo ndër vite në vendosjen dhe mbrojtjen e themeleve të rendit kushtetues. Në vazhdim ajo foli edhe për procesin e vendimmarrjes së Gjykatës dhe referimit të vazhdueshëm që në çdo vendim të saj i bëhet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kryetarja Caka-Nimani në fund i porositi studentët që të angazhohen sa më shumë në studimet e tyre universitare dhe në përvetësimin e njohurive profesionale, me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të strukturës ligjore të vendit përballë sfidave të së ardhmes.

Në prezantimin e tij para studentëve të UPZ-së, gjyqtari Safet Hoxha ndërkaq bëri një elaborim të shkurtër përkitazi me strukturën dhe përbërjen e Gjykatës Kushtetuese, me procesin e parashtrimit të kërkesave dhe trajtimin e tyre deri në vendimmarrjen e gjyqtarëve.

9 qershor 2023

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i përbërë nga Zëvendëskryetari i Gjykatës, z. Bajram Ljatifi dhe gjyqtarët Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, Safet Hoxha dhe Radomir Laban, mori pjesë në një punëtori të përbashkët me gjyqtarët e Gjykatave Themelore të Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit, e cila u organizua me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në qytetin e Gjakovës.

Temë e diskutimit të përbashkët të gjyqtarëve kushtetues dhe të gjyqtarëve të tri Gjykatave Themelore ishin, ndër të tjera, ndërveprimi i juridiksionit gjyqësor dhe kushtetues për garantimin e shtetit të së drejtës dhe administrimi i duhur i drejtësisë në kontekst të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Roli i gjykatave të rregullta në interpretimin e Kushtetutës, baza juridike dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në raport me “kontrollin incidental”, divergjenca e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta dhe e drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si dhe vendosja e rasteve brenda një afati të arsyeshem dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, ishin disa prej temave të cilat gjyqtarët kushtetues i trajtuan në prezantimet e tyre.

Punëtorja e mbajtur shënon vazhdimësinë e takimeve konsultative profesionale ndërmjet gjyqtarëve kushtetues dhe gjyqtarëve të gjyqësorit të rregullt, në shërbim të përmirësimit të administrimit të drejtësisë dhe forcimit të sundimit të ligjit në vend.

30 qershor 2023

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë morën pjesë në një punëtori të përbashkët që u organizua në “Hotel Swiss Diamond” në Prishtinë më 30 qershor 2023.

Ankimi kushtetues si e drejtë substanciale, gjykimi brenda një kohe të arsyeshme dhe kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve, ishin vetëm disa ndër temat të cilat u trajtuan në prezantimet dhe diskutimet e gjyqtarëve kushtetues të të dyja vendeve. Me të përfunduar të punëtorisë, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani dhe gjyqtarët e tjerë kushtetues, pritën në takim të përbashkët në ambientet e gjykatës delegacionin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në krye me kryetaren e kësaj gjykate, znj. Holta Zaçaj.

Temë e diskutimit të përbashkët ishin të arriturat e deritanishme në fushën e drejtësisë kushtetuese të të dyjave vendeve, përpjekjet e bëra për modernizimin e sistemeve elektronike për menaxhimin e rasteve dhe për unifikimin e praktikave gjyqësore, si dhe sfidat kryesore në funksionimin e të dy gjykatave dhe përvojat reciproke në tejkalimin e tyre.

18 - 19 korrik 2023

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në vijimësi të organizimit të punëtorive të përbashkëta profesionale, morën pjesë në punëtorinë e radhës të organizuar me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ), e cila u mbajt në Selanik më 18 – 19 korrik 2023.

Pas fjalëve hyrëse të kryetares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka-Nimani, kryetarit të Gjykatës Supreme, z. Fejzullah Rexhepi dhe përfaqësuesit të IRZ-së, z. Frank Hupfeld, punëtorja dyditore i vazhdoi punimet me diskutimet e pjesëmarrësve në temat: “E drejta e qasjes në gjykatë”, “E drejta për liri dhe siguri – rastet e paraburgimit” dhe “E drejta në vendim të arsyetuar”, ku me prezantimet e tyre u paraqitën gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese: z. Safet Hoxha, z. Nexhmi Rexhepi, dhe z. Enver Peci, si dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme: z. Shukri Sylejmani, z. Ragip Namani dhe z. Agim Maliqi.

Temë diskutimi në punëtorinë e mbajtur ish-in edhe çështja e zbatimit të vendimeve të gjyqësorit të rregullt dhe të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, shkëmbimi i informatave relevante me gjyqësorin e rregullt lidhur me rastet në trajtim në Gjykatën Kushtetuese, si dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit reciprok në funksion të lehtësimit të procedurave administrative gjyqësore për palët parashtruese.

Moderator i punëtorisë ishte z. Winfried Schubert, ish-gjyqtar dhe ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të rajonit Saxony-Anhalt, si dhe ish-Kryetar i Gjykatës Rajonale më të Lartë në Naumburg të Gjermanisë, i cili me prezantimet e tij në secilin panel të temave të trajtuara solli perspektivën dhe përvojën e gjyqësorit të rregullt dhe gjyqësisë kushtetuese gjermane.

8 - 9 shtator 2023

U mbajt punëtorja për hartimin e Planit të ri të Veprimit për Planin Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për vitet (2024 - 2025), organizuar me përkrahjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë.

18 - 21 shtator 2023

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë, z. Jeton Bytyqi dhe z. Dardan Berisha morën pjesë në programin e “Shkolla e 11-të Verore” mbi temën “Judicial Independence as a Safeguard of the Right to a Fair Trial” të mbajtur më 18 - 21 shtator 2023, në Ankara.

21 - 23 shtator 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani, mori pjesë në seminarin ndërkombëtar me temën “Kushtetutshmëria dhe Sundimi i Ligjit”, organizuar në Londër nga Fakulteti Juridik në kuadër të Universitetit Notre Dame dhe Shoqëria Federale Amerikane për Studime të Ligjit dhe të Politikave Publike.

6 tetor 2023

Gjykata Kushtetuese mori pjesë në tryezën e diskutimit së bashku me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave vendore, organizuar me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë, e cila u mbajt më 6 tetor 2023 në Prishtinë.

Pas fjalëve hyrëse të Kryetares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka-Nimani dhe drejtorit të Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje në USAID, z. Noel Bauer, tryeza e diskutimit u pasua nga transmetimi i një video-prezantimi përkritazi me procesin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, të realizuar me përkrahjen e USAID. Gjatë bashkëbisedimit, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave paraqitën pikëpamjet e tyre përkritazi me bashkëpunimin e deritanishëm me Gjykatën Kushtetuese në aspektin e komunikimit, trajtimit të kërkesave të parashtruara për qasje në informata zyrtare, si dhe interpretimit të drejtë, por edhe keqinterpretimit të përmbytjes së vendimeve të Gjykatës në opinion.

19 tetor 2023

Me qëllim të përmirësimit të komunikimit me publikun dhe qasjen më të lehtë të qytetarëve dhe mediave në informatat më të fundit përkitazi me punën dhe veprimtarinë e saj, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës hapi faqen e saj zyrtare në rrjetin social “Facebook”.

23 - 25 tetor 2023

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kremtoi përvjetorin e 14^{-të} të Vitit Gjyqësor me një ceremoni solemne të mbajtur më 23 tetor 2023 në Prishtinë. Në Ceremoni morën pjesë udhëheqësit më të lartë shtetërorë, përfaqësuesit e akredituar të misionëve diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare në vend, si dhe delegacionet e nivelit më të lartë nga Gjykata Kushtetuese e Austrisë, Gjykata Kushtetuese e Belgjikës, Gjykata Kushtetuese e Bosnjë dhe Hercegovinës, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë, Gjykata Supreme e Estonisë, Këshilli Kushtetues i Francës, Gjykata Supreme e Holandës, Gjykata Supreme e Irlandës, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, Gjykata Kushtetuese e Letonisë, Gjykata Kushtetuese e Lituaniës, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë Veriore, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Supreme Administrative e Portugalisë, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë e Shqipërisë, dhe Gjykata Kushtetuese e Turqisë. Pjesëmarrës në ceremoninë e Vitit të 14^{-të} Gjyqësor ishin edhe përfaqësuesit nga Komisioni i Venecias dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në shënim të 14-vjetorit të punës së Gjykatës Kushtetuese, më 24 tetor 2023 mbahet edhe Konferenca ndërkombëtare me temën “*Kontributi i Gjykatave Kushtetuese në mbrojtjen dhe forcimin e vlerave themelore të demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*”.

10 nëntor 2023

Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës u mbajt punëtoria informuese me gjyqtarë të sapoemëruar, e organizuar në kuadër të programit të trajnimit fillestar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

Gjyqtarët e rinj u pritën në takim nga gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhmi Rexhepi, i cili gjatë prezantimit të tij diskutoi përkitazi me rolin dhe kompetencat që gëzon Gjykata në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, për strukturën organizative të saj, si dhe palët e autorizuara për parashtrimin e kërkesave.

12 nëntor - 12 dhjetor 2023

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës në Prishtinë “*Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese*”, Gjyqtari Enver Peci dhe Shefja e Kabinetit Zyra Cela u vendosen në GJEDNJ për vizitë studimore një muajshe.

8 dhjetor 2023

Me rastin e “Ditës së Gjykatës së Hapur”, të organizuar në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, Gjykatën Kushtetuese e vizituan dhjetëra studentë të fakulteteve juridike dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë.

Studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka” ishin në grupin e parë të vizitorëve që në takim u pritën nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci. Gjatë prezantimit të saj, gjyqtarja Istrefi-Peci foli rreth historikut të themelimit të Gjykatës Kushtetuese, organizimit të punës së deritanishme dhe kompetencave kushtetuese të

Gjykatës. Ndërsa, gjyqtari Hoxha bëri një elaborim të shkurtër mbi rëndësinë e respektimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe Ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Gjyqtari Radomir Laban priti në takim grupin e dytë të vizitorëve, të përbërë nga studentë të Klinikës Ligjore të Qendrës për Ndihmë Juridike Falas të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), të cilët i informoi mbi veprimtarinë e deritanishme të Gjykatës, rastet me të cilat Gjykata është marrë së fundi, përfshirë të drejtën në jetë si pasojë e dhunës në familje, si dhe mendimet mospajtuuese dhe konkurruese të gjyqtarëve.

Grupi i tretë i vizitorëve në “Ditën e Gjykatës së Hapur” ishin nxënësit e institucionit arsimor për Arsimim Profesional “Hoxhë Kadri Prishtina”, të cilët në takim u pritën nga Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese Bajram Ljatifi dhe gjyqtari Nexhmi Rexhepi. Përderisa Zëvendëskryetari Ljatifi i njoftoi nxënësit në pika të shkurta përkitazi me historikun e së drejtës kushtetuese në vend dhe të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar, gjyqtari Rexhepi bëri një prezantim mbi rolin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese, mandatin e gjyqtarëve kushtetues, si dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutën e vendit tonë.

Aktiviteti “Dita e Gjykatës së Hapur” u përmbyllë me vizitën e studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, të cilët në takim u pritën nga gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, e cila ndër të tjera, juristet e ardhshëm i informoi përkitazi me raportin e Gjykatës Kushtetuese me gjyqësorin e rregullt dhe mekanizmin e kontrollit incidental, me kriteret e parashtrimit të kërkesave nga qytetarët dhe palët e autorizuara për të parashtruar kërkesë, si dhe me zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

13 dhjetor 2023

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar “IRZ”, organizon konferencën e përbashkët me Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe me Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës më temën “*Ekulibri ndërmjet Kontrollit të Ligjshmërisë dhe të Kushtetutshmërisë, Kufijtë e Juridiksionit dhe qasja në Drejtësi*”.

Kjo është konferenca e dytë e përbashkët e kësaj natyre që organizohet ndërmjet gjykatave simotra të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Krahas gjyqtarëve nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, në mesin e panelistëve kryesor në konferencë ishte edhe ish-gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, znj. Gabriele Britz.

18 - 19 dhjetor 2023

Mbahet punëtorja me gjyqtarët dhe stafin e Gjykatës Kushtetuese “Standardet e Konventës së Stambollit dhe referenca e tyre në aktgjykimet e GJEDNJ-së” mbështetur nga Projekti i Këshillit të Evropës “Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit”. Kjo punëtori synonte të forcojë kapacitetet e gjyqtarëve dhe stafit të Gjykatës Kushtetuese për të zbatuar standardet e Konventës së Stambollit dhe referencën e saj në aktgjykime.

20 dhjetor 2023

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i përbërë nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka-Nimani dhe gjyqtarët: Remzije Istrefi-Peci, Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci, mori pjesë në një punëtori të përbashkët me gjyqtarët e gjykatave themelore të Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës dhe Ferizajit, e cila u organizua me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës, në Prishtinë.

Temë e diskutimit të përbashkët të gjyqtarëve kushtetues dhe të gjyqtarëve të katër gjykatave themelore ishin, ndër të tjera, ndërveprimi i juridiksionit gjyqësor dhe kushtetues për garantimin e shtetit të së drejtës, dhe administrimi i duhur i drejtësisë në kontekst të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Roli i gjykatave të rregullta në interpretimin e Kushtetutës, baza juridike dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në raport me “kontrollin incidental”, divergjenca e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta dhe e drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si dhe vendosja e rasteve brenda një afati të arsyeshëm dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, ishin disa prej temave të cilat gjyqtarët kushtetues i trajtuan në prezantimet e tyre.

Punëtorja e mbajtur shënon vazhdimësinë e takimeve konsultative profesionale ndërmjet gjyqtarëve kushtetues dhe gjyqtarëve të gjyqësorit të rregullt, në shërbim të përmirësimit të administrimit të drejtësisë dhe forcimit të sundimit të ligjit në vend.

SHTOJCA I

SHTOJCA I

Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2023
Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme

Shën.	2023			2022			2021		
	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme
	BKK	THV		BKK	THV		BKK	THV	
	€	€	€	€	€	€	€	€	
Pranimet									
Ndarjet nga Fondi i përgjithshëm	1,958,212.5			1,825,629.0			1,958,013		
Të hyrat vetanake									
Ndarjet nga Fondi me qëllime të dedikuara									
Grantet e përcaktuara të donatorëve	69,801.69								
Fondi i huazimeve									
Pranimet e tjera	903.99								
Totali i pranimeve	2,028,918.2	-	-	1,825,629.0	-	-	1,958,013	-	
	3			0					
Pagesat									
Operacionet									
Pagat dhe mëditjet	2	1,223,457.2		1,209,699			1,296,201		
Mallrat dhe shërbimet	3	595,605.96		541,634			546,106		
Shërbimet komunale	4	3,977.04		2,750			2,583		
		<u>1,823,040.2</u>		<u>1,754,083.1</u>			<u>1,844,890.34</u>		
		<u>2</u>		<u>9</u>					
Transferet									
Transferet dhe subvencionet	5	79,531.92		71,546					
Shpenzimet kapitale		56,544.40					113,238		
Prona, ndërtesa dhe pajisjet	6								
Pagesat nga granti KE	7	69,801.69							
Pagesat e tjera	8								
Pagesat gjithsej		2,028,918.2	-	1,825,629.1	-	-	1,958,128.34	-	-
		3		9					

Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit

Shënime	2023				2022	2021	
	Realizimi	Buxheti final (Ndarja)	Buxheti fillestar	Dallimi	Realizimi	Realizimi	
	A	B	C	D=C-B	E	F	
	€	€	€	€	€	€	
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	9						
Të hyrat jo tatimore	10						
Të hyrat dedikuara	11						
Grantet dhe ndihma	12						
Huamarrje	13						
Tjera	14						
Pranimet totale të mbledhura për BKK		-	-	-	-	-	
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	2	1,223,457	1,395,781	1,395,781	172,324	1,209,699	1,296,201
Mallrat dhe shërbimet	3	595,606	598,662	518,000	3,056	541,634	546,106
Shërbimet komunale	4	3,977	4,000	4,000	23	2,750	2,583
Transferet dhe subvencionet	5	79,532	80,080	80,080	548	71,546	
Shpenzimet kapitale	6	56,544	61,338	110,000	4,794		113,238
Granti nga KE	7	69,802	72,000	72,000	2,198		
Të tjera	8						
Totali i pagesave të bërë nga BKK		2,028,918	2,211,861	2,179,861	182,943	1,825,629	1,958,128

Ndarjet e fondit të përgjithshëm për vitin 2023

Klasifikimi ekonomik	2023			2022	2021
	BKK	THV	Totali		
	€	€	€	€	€
Pagat dhe mëditjet	1,223,457.22		1,223,457.22	1,388,837	1,296,201
Mallrat dhe shërbimet	598,662		598,662	565,856	546,106
Shërbimet komunale	4,000		4,000	4,000	2,583
Subvencionet dhe transferet	80,080		80,080	77,580	
Shpenzimet kapitale	61,338		61,338	45,000	113,238
Grantet nga KE	72,000		72,000		
	2,039,537.22	-	2,039,537.22	2,081,273	1,958,128

ORGANOGRAMMI



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE USTAVNI SUD CONSTITUTIONAL COURT

